



ZGJEDHJET

Rama zgjeron koalicionin, takime me Topin e Dulen

Mediu i vë kushte Bashës: Brenda 10 ditëve prano Dukën në Durrës

► FAQE8-9

LISTA

Pronat, ja 186 personat që duhet të paraqiten në AKKP

Agjencia, shpallje publike me emrat e subjekteve të shpronësuar dhe kërkesve

AKKP ka publikuar në faqen e vet zyrtare emrat e 186 pronarëve dosjet e të cilëve gjenden në proces verifikimi e shqyrtimi, por që nuk mund të kontaktohen nga institucioni. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit ka publikuar emrat e subjekteve të shpronësuar dhe të...

► FAQE 12



KOMENT



NGA **AFRIM KRASNIQI**

Në zgjedhje pa ofruar zgjidhje?

S elitë e partive politike janë bërë objekti dhe burimi kryesor i lajmit ditor, për shkak të negociatave mbi emrat e mundshëm për kryetarët e rinj të qeverisjes vendore.

► vijon në faqen 16

KOMENT



NGA **FATOS ÇOCOLI**

Paratë e krimit

E dhe pse krimi ekonomik në vendin tonë duket se po zbulohet dhe ndëshkohet në nivelet...

► vijon në faqen 16

[SHQIPTARJA.com]

LEKË 30


VITI V - NR. 74 - E MËRKURË - 01-04-2015

FSHEHJA E "DOSJES FRROKU", DIDI DETYROHET TE JAPE DOREHEQJEN

DY GABIMET E BELGEVE QE SHPETUAN FRROKUN

- Këshilli i Mandateve, PS-PD bashkojnë votat për t'i hapur rrugë arrestimit të Frrokut
- Dorëheqja e drejtorit të Policisë, opozita në sulm. Rama padit PD: Të faktojë jashtënjerrjet në Gjykatë

► FAQE 2-5



ITALI

Ambasadori Ceka pazare me votat e shqiptarëve

► FAQE 6

MBRESA

Zana Lita: Si e njoha Musine Kokalarin në Rrëshen

► FAQE 20



INTERVISTA

Gjoshja: BE, herët për të kërkuar anëtarësimin

► FAQE 7



Blue Medical Center

Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 868

Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

» ÇESHTJA “FRROKU”

KËRKESA zyrtare për dorëheqjen e Artan Didit i'u paraqit Ministrin Saimir Tahiri dhe Kryeministrin Edi Rama

Fshehja e dosjes “Frroku”, Artan Didi jep dorëheqjen


“Shkelja e dy drejtuesve të lartë të Interpolit, ngjarje e papranueshme. Ka cënuar imazhin”

XHENSILA KODRA
TIRANE

Dosja “Frroku” shkakton viktimën e parë në polici. Kryepolici Artan Didi, gjatë ditës së djeshme ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme nga funksioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në një kërkesë zyrtare për dorëheqje që Didi i paraqiti Ministrin të Brendshëm Saimir Tahiri dhe Kryeministrin Edi Rama, ai sqaron edhe arsyet që e shtynë drejt këtij vendimi të papritur. Sipas burimeve, Didi ia ka përcjellë vendimin drejtuesve më të lartë të Policisë në një mbledhje me dhyer të mbyllura në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ndërkohë, shkelja që bënte dy drejtuesit e lartë të Interpolit, duke fshehur kërkesën e autoriteteve belge për arrestimin e deputetit Frroku me akuzën e vrasjes, për Didin është një ngjarje e papranueshme që ka cënuar imazhin e Policisë së Shtetit. Edhe pse ishte po Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (siç shprehet Didi), që korrigjoi gabimin duke vënë përpara përgjegjësisë penale shefin e Interpol Tirana, Artan Bajraktari dhe oficeren operatore Laureta Alla, për të mbetet i papranueshëm fakti që nuk e parandaloi shkeljen e ligjit. Në kërkesën që Didi i drejtoi Tahirit dhe Ramës, ai shkruan se “Duke vlerësuar këtë ngjarje si të papranueshme për prestigjin e Institutit të Policisë së Shtetit, të cilin unë e drejtoj, duke vlerësuar që nuk pata kapacitetin e mjaftueshëm për të parandaluar një fakt të tillë, vendosa të jap dorëheqjen e parevokueshme nga funksioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit”. Artan Didi mbante postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që nga tetori i vitit 2013, pas ardhjes së të majtës në pushtet. “Modelin e punës që u mundova të punoja në institucion po e shoqëroj me modelin e punës që u mundova të punoja në institucionin që u drejtoja. Shkelja e procedurave ligjore të specialitit të Interpolit dhe të shefit të këtij sektori, shkelje që i vuri ata përpara përgjegjësisë penale, cenoi në njëfarë mase imazhin e Drejtorisë së Përgjithshme të policisë, ndonëse ishte po ky institucion që e korrigjoi gabimin”, shkruan Didi në kërkesën e tij drejtuar

jore të specialitit të Interpolit dhe të shefit të këtij sektori, shkelje që i vuri ata përpara përgjegjësisë penale, cenoi në njëfarë mase imazhin e Drejtorisë së Përgjithshme të policisë, ndonëse ishte po ky institucion që e korrigjoi gabimin”, shkruan Didi në kërkesën e tij drejtuar

ar Ramës dhe Tahirit. Teksa nënvizon se pikërisht duke vlerësuar këtë ngjarje si të papranueshme për prestigjin e institucionit të Policisë që ai drejtoi dhe se nuk mundi të bëjë asgjë për të parandaluar një fakt të tillë, ka dhënë dhe dorëheqjen e parevokueshme. “Punonjësit e ndershëm të policisë të më gjykojnë për këtë vendim”, thotë Didi.



Didi, karriera e 52-vjeçarit që drejtoi Policinë e Shtetit Super-aksioni në Lazarat pika kulmore e karrierës



Artan Didi mori drejtimin e Policisë së Shtetit në tetor të vitit 2013. Ai e ka nisur karrierën si drejtues i lartë i Policisë në 1997, kur ka qenë drejtues i repartit të Forcave Speciale RENEJA deri në 2000. Më pas Didi ka drejtuar Forcat e Ndërhryrjes së Shpejtë. Didi u shqua dhe u bë i njohur pasi shpëtoi një atentat më 24 tetor të vitit 1998, gjatë një aksioni për kapjen e një shtetasi arabo-egjiptian, që kërkohet për 25 krime dhe terrorizëm. Artan Didi mbeti i plagosur gjatë aksionit që u zhvillua në Tiranë, kur RENEJA-s shkoi për të arrestuar shtetasin arab që hapi zjarr ndaj Policisë, por më pas mbeti i

Haki Çako
Ja se kush do ta drejtojë Policinë e Shtetit!



Pas dorë-heqjes së parevokueshme të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Artan Didi i paraqiti Ministrin Saimir Tahirit, si dhe Kryeministrin Edi Rama, në krye të uniformave blu është komanduar Haki Çako. Pas operacionit të Lazarat, Çako u emërua si zv.drejtor i përgjithshëm për krimet e rënda, ndërsa që nga dita e djeshme ai ka marrë funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm deri në emërimin e zëvendësuesit të Didit. Çako ka një karrierë 23 vjeçare në Policinë e Shtetit, ndërsa para se të emërohej zv.drejtor ai ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Qarkut në Gjirokastrë. Drejtori i ri pritet të propozohet nga Ministri Tahiri e më pas Kryeministri Rama të firmosë këtë propozim, por deri sa të ndodhë kjo uniformat blu do të drejtohen nga Haki Çako.



Artan Didi
“Duke vlerësuar këtë ngjarje si të papranueshme për prestigjin e Institutit të Policisë së Shtetit, të cilin unë e drejtoj, vendosa të jap dorëheqjen e parevokueshme”

PËR DIDIN

Pjerin Ndreu: Viktimë e llumit politik të PD

Deputeti socialist i Tiranës, Pjerin Ndreu, një nga ish-drejtesit e lartë të Policisë ka reaguar rreth dorëheqjes së Artan Didit. “Kjo politikë vjen pikërisht nga stani i llumit të PD që bëri drejtues policie marangozë, muratorë, etj, duke e kthyer Policinë e Shtetit në parcelë eksperimentale që krimi të livadhiste si ti donte qejfli! Didi është viktimë e radhës megjithëse e kaloi me shumë lavdi periudhën e drejtimit të Policisë Shtetit! Si ish-drejtes i lartë policie, i pari që kam dhënë dorëheqjen nën presionin e politikës së kriminalizuar jam në krah të Didit, duke kërkuar përgjegjëshmëri nga politika që drejtuesit e policisë të mos hidhen në rrugë si lecka!”



DORËHEQJA E DIDIT

Berisha: Larje hesapesh mes kockave mafioze të pushtetit


"Frroku", Basha: Minë në themelet e Policisë e shtetit

Demokratët dorëheqjen e djeshme të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi e kanë shfrytëzuar për sulme ndaj kryeministrit Edi Rama dhe ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri.

Ish-kryeministri Sali Berisha në rrjetin social 'Facebook' e ka quajtur dorëheqjen e Didi larje hesapesh midis kockave mafioze të pushtetit të krimit, duke marrë parasysh faktin që sipas tij, Didi së bashku me Ministrin e Brendshëm Saimir Tahiri ishin në dijeni për kërkesën belge për Mark Frrokun që në fillim.

"Cubin Didi e hëngri krimi i pushtetarëve! Larje hesapesh midis balozëve të krimit në krye të pushtetit! Këshilli i vrasësve largoi dhe flaku si limon të shtrydhur, vrasësin, cubin mercenar që rrënoi Policinë e Shtetit, Artan Didi", akuzon Berisha. Sipas tij, shkarkimi u bë për të larë duart me fshhejen e krimit që për tre muaj kjo qeveri kishte mbajtur kërkesën e autoriteteve belge për Frrokun. Berisha tha se Bajraktari kishte informuar jo vetëm Didin po dhe Tahirin. "Thuhet se Didi kishte denoncuar te të huajt lidhjen e Tahirit me Shullazin, etj. Kurse

Tahiri mbante peng Didin në një transfertë 500 mijë eurosh te tij në një vend mik si dhe disa emërime në Polici", tha Berisha. Që s'jaftohet me kaq, kur thotë se "dhimbjen për flakjen e cubit Didi do ta kthejmë në forcë kundër opozitës, deklaracion Rama me gojën e Saimir Shullazit". Ndwsra kreu i PD Basha, dhe ky nw Facebook shkruan se ngjarja e fundit për çështjen 'Frroku' që çoi në arrestimin e dy zyrtarëve të Interpol në Shqipëri e dorëheqjen e drejtorit Didi, është një minë në themelet e policisë e të shtetit. "Kryeministri i kriminalizimit kërkon të bëhet patjetër qesharak me sulmet dhe kërcënimet ndaj opozitës. Krugët e tre shokëve nuk u ndanë për asnjë parim apo moral. Krugët e tre shokëve u ndanë vetëm se ligjësi të mafias janë të këtitilla. Padrino të flak në fund për të mbajtur karrigen e tij", shkruan Basha. Ndwsra sekretari i Përgjithshëm i Arben Ristani tha se Rama ishte informuar nga Brukseli për akuzat e vrasjes së kryer nga Mark Frroku. Nënkryetari i grupit tw PD Edmond Spaho ka kërkuar dorëheqjen e ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri.




Berisha

"Mark Frroku, vrasësi i mire i Partisë, u mbrojti apo u mor peng nga Rama-Meta për të ndryshuar dëshminë e tij të porositjes nga Meta të vrasjes së dy deputetëve".

Saimir Tahiri: Dorëheqja e Artan Didit, akt dinjiteti

Ministri i Brendshëm ka vlerësuar punën e ish-drejtorit



Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, në një konferencë për mediat gjatë ditës së djeshme, tha se vendimi për dorëheqjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi është një shembull dhe përgjegjësi morale. Gjatë deklaratës së tij, Tahiri theksoi se standardi i Qeverisë është i njëjtë dhe se zbatim i ligjit është njësoj për të gjithë. Sa i përket arrestimit të dy zyrtarëve të Interpol Tiranës, që sipas hetimeve drejtori i Interpol Tiranës, Artan Bajraktari dhe specialistja, Laureta Alla nuk kanë njoftuar autoritetet që Mark Frroku ka qenë i kërkuar në Belgjikë, Ministri Tahiri tha se kjo nuk na bën të ndihemi mirë. Megjithatë, Tahiri tha

se forca vetëkorrigjuese e policisë tregon se ligji po funksionon. Ai u shpreh se: "Përpara ligjit të gjithë jemi të barabartë dhe në respekt

të këtij besimi që duam të forcojmë tek të gjithë, dimë të mbajmë qëndrimin e duhur jo vetëm ligjor por edhe moral". Gjithashtu, Tahiri

theksoi përgjegjësinë morale që Drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Artan Didi, ka marrë gjatë ditës së djeshme duke u dorëhequr



Saimir Tahiri

Pas një hetimi paraprak. Inspektimi i Ministrit të Brendshëm dhe Shërbimi për Ankesat dhe Çështjet e Brendshme, konkludoi se nuk ishin zbatuar saktë procedurat e parashikuara nga ligji, ndaj për këtë arsye, për 2 punonjës të policisë ka nisur ndjekja penale po nga shërbimi ynë i brendshëm referuar me pas Prokurorisë

për të dhënë mesazhin e qartë e të fortë të dinjitetit të Policisë që po rilindin. "Marrja e kësaj përgjegjësie është akti kuqimplotë i vullnetit tonë të përbashkët për të ndërtuar mes njëmijë e një vështirëve objektive, po edhe përballë plot pengesave artificiale të politikës së baltës, frymën e ligjshmërisë, modelin e transparencës dhe moralin e mosfshhejes para përgjegjësi që duhet ta mishërojë çdo punonjës i Policisë së Shtetit", ka thënë Ministri Tahiri në deklaratën e tij. Ndërkohë, Ministri Tahiri nuk "Më vjen keq që Artan Didi nuk do të jetë më në krahun tim të djathtë. Integriteti dhe kurajaja e tij ishin një aset i çmuar në këtë rrugë të vështirë rilindjeje të Policisë së Shtetit, dhe besoj një model për tu ndjekur nga punonjësit e ndershëm të Policisë së Shtetit. Ashtu siç më vjen mirë që sot atë e njohën si një qytetar besnik të ligjit të vlerave morale edhe ata që deri dje nuk dinin asgjë për të", ka thënë në fund të deklaratës së tij Ministri i Brendshëm Saimir Tahiri.

Padi dhe Tahiri

Rama padit PD: Të faktojë jashtënxjerrjet në Gjykatë

— Kryeministri Rama do depozitë në Prokurori një kallëzim penal ndaj PD-së për akuzat se fshheja që autoritetet shqiptare i bënë dosjes së Belgjikës për Frrokun është bërë me dijeninë e tij. "Një tjetër kallëzim do nisët një orë e më parë drejt Prokurorisë së Përgjithshme dhe Gjykatës së Lartë, për përkallëzimin e aktivitetit kriminal të shpifjes nga ana e SHQUP-it. Nëse kanë një provë të vetme, jam unë që do përgjigjem përpara ligjit. Por nëse përsëri do dalin si qyqarë para trupit gjykues e do përsërisin avazin banal se shpifja është e drejtë e njeriut e ata s'mbajnë përgjegjësi për atë që thonë, atëherë janë ata që duhet

të ndëshkohen sipas ligjit. Ky aktivitet kriminal duhet gjykuar jo vetëm me fuqinë e votës po dhe me forcën e ligjit", shkruan Rama. Ministri i Brendshëm Tahiri tha se "do të çojmë menjëherë kallëzimin penal, qoftë unë qoftë Kryeministri i Shqipërisë, dhe ju siguroj se po njësoj si në gjyqin për shpifje që po zhvillohet aktualisht, do thonë prapë ne s'dimë gjë, s'kemi prova s'kemi fakte, po kështu e mendon PD. Zbardhjen e akuzave të tyre kriminale përmes Gjykatës së Lartë i'a detyrojmë publikut, jo atyre që deri dje qeverisën si një bandë e organizuar, ndërsa sot ulërasin si lukuni e dëshpëruar".

Sidoqoftë shkëlqen e ka zbuluar, hetuar dhe proceduar po Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit

» ÇESHTJA “FRROKU”

ERMIRA MRRUKU
TIRANE

Mazhoranca dhe opozita edhe pse mes debatesh të shumta, kanë bashkuar votat në mbledhjen e djeshme të Këshillit e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, duke i sugjeruar Kuvendit dhënien e autorizimit Prokurorisë për arrestimin e deputetit Mark Frroku. Kërkesa e organit të akuzës për autorizimin nga Kuvendit, për arrestimin e Frrokut ka ardhur pasi dyshohet se ky i fundit në vitin 1999, është përfshirë në një vrasje të ndodhur në Belgjikë, për të cilën rezultoi i dënuar në vitin 2010. Mbledhja e cila zgjati për afro 1 orë e 30 minuta u shoqërua me debate të shumta mes deputetëve të opozitës dhe kreut të Kuvendit Ilir Meta. Si fillim opozita e ngriti debatin mbi kërkesën e tyre, që kryeparlamentari Meta të mos drejtohej Këshillin për këtë çështje, pasi sipas tyre ka konflikt interesi, pasi Meta është i akuzuar kryesor për atentatin që sipas Doshit do kryhej ndaj tij dhe Mhill Fufit. Ndërkohë që pjesë e debateve ka qenë edhe data kur është sjellë dokumenti i zyrta i autoriteteve belge, ku deputetët e PD-së u shprehën se janë fshehur qëllimisht dy kërkesat e

PS-PD bashkojnë votat për arrestimin e deputetit Frroku

Deklarata: Në kohën e vrasjes s’kam qenë në Belgjike. Në Shengen kam lëvizur deri në 22 Shkurt

para. Nga ana tjetër, avokatët e Frroku kërkuar rrëzimin e Kërkesës e Prokurorisë. Ndërsa Prokuroria është treguar e rezervuar duke deklaruar se ruan sekretin hetimor. Megjithatë deputeti Mark Frroku gjatë fjalës së tij deklaroi se nuk ka qenë në

Belgjikë, kur ka ndodhur vrasja dhe kjo sipas tij është e verifikueshme. “Dua të them që nuk kam vrarë asnjë njeri, dhe nuk kam bashkëpunuar me askënd për vrasjen e askujt. Autoritetet belge të më provojnë vetëm një fakt të vogël që unë në atë kohë kam qenë

në Belgjikë dhe unë jam gati të pranoj vrasjen. Unë kam qenë në vendin tim në atë kohë”, tha Frroku. Sa i përket urdhrin ndërkombëtar për arrestim, Frroku thotë se ka udhëtuar pa asnjë problem deri më 22 shkurt në vendet e zonës Shengen.

PS DHE PD kanë bashkuar votat në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit për të dhënë autorizimin e kërkuar nga ana e Prokurorisë për arrestimin e Mark Frroku



Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit

Takimi

Frroku takim miqësor me kolegët që e “çuan” në pranga

Pak para nisjes së mbledhjes djeshme, deputeti Frroku ka ndarë disa momente miqësore me kolegët e tij deputetë, të cilët votuan në seancën e së enjtes pro arrestimit të tij për çështjen “Doshi”. Megjithatë, oavarësisht vendimit që u morrë seancën plenare të javës së shkur, kreu kristian demokrat, nuk është shmangur nga kolegët e tij, përkundrazi ka ndarë pak minuta me ta. Menjëherë pas vendimit për heqjen e imunitetit, Frroku ra në prangat e Policisë por Gjykata e Lartë vendosi ndaj tij masën e sigurisë “arrest me burg”. Frroku akuzohet nga drejtësia shqiptare se ka inskenuar historinë që Doshi denoncoi publikisht për një atentat ndaj tij dhe demokratit Mhill Fufi gjashtë muaj më parë.

Prova

“Avokatët do të bëjnë publike se çfarë provash ka në shkresën e Prokurorisë, me mua s’ka lidhje ajo çështje”, tha Frroku

Sqarimi

Frroku ka sqaruar edhe “takimin e baballarëve”, por tha se ky takim nuk ka ndodhur në vitin 1999 siç thuhet në relacion, por rreth para dy vjetësh.



Avokati

“Nëse ka pasur urdhër arresti, deri më 22 shkurt 2015 kemi lëvizur lirish në zonën Shengen, që do të thotë që s’ka urdhër arresti ndërkombëtar”, tha Vishaj.



Ristani: Ku është shkresa e urdhër arrestit?

Avokati Vishaj: Mark Frroku ka lëvizur deri më 22 shkurt në zonën Shengen

RISTANI-METËS: Kërkesa belge për Frrokun ka qenë e njohur në janar, ju e keni fshehur për të manipuluar hetimet. Prandaj ju keni konflikt interesi duhet të largoheni.

META: Unë nuk kam ndërmend të largohem, ju po të doni të largoheni, largohuni. Konfliktin e interesit le ta gjykojnë ata që na ndjekin.

HALIMI: Këtu ka një kërkesë për largimin tuaj.

META: Nuk largohem unë, ikni ju po të doni, mbaj përgjegjësi. Jemi për gjë tjetër këtu, nuk jemi për të dëgjuar kaseten tënde.

HALIMI: Ka konflikt interesi se këta zotëri të kanë akuzuar për porositjen e vrasjes së dy deputetëve.

PROKURORIA: Materiali i ardhur është urdhër arresti ndërkombëtar për deputetin Frroku. Informacioni në urdhër arrestin është konfidencial dhe nuk mund ta bëj publik.

RISTANI: Si na e provoni që ju ka ardhur shkresa për arrestin ndërkombëtar? Shkresat çfarë përba-jnë, çfarë lidhje kanë me deputetin Frroku?

PROKURORIA: Ne i kemi cituar të gjitha materialet në relacion, urdhër kërkimi ndërkombëtar për deputetin Frroku.

RISTANI: A ka mundësi të shohim se ajo që thoni ju këtu është e njëjta me ato që ju kanë ardhur në shkresë?

PROKURORIA: Kërkesat tona dhe materialet shoqëruese janë përmendur në relacion, unë

nuk mund ti vë në dispozicionin tuaj, por në dispozicion të Prokurorisë. Dokumentet që ne kemi janë të institucioneve ndërkombëtare. Nuk besoj që vërtetësia e tyre të vihet në dyshim nga askush prej nesh.

RISTANI: Për mua jeni dy palë që vini këtu, ju kërkoni arrestim për të. Dua të shikoj nëse ju jeni korrekt në kërkesën tuaj apo jo, se s’kam si ju besoj apriori.

META: Nuk ishin i kënaqur nga përgjigjia që morët nga prokuroria, nëse e gjykojmë më pas të nevojshme për dokumente shtesë që

ju mendoni se nuk dëmton procesin këtë gjë mund ta bëni më pas. Mendoj të vazhdojmë edhe me çështjet e tjera.

RISTANI: Këtu ne s’kemi asnjë lloj dokumenti. Dua të shikoj dokumentin e Interpolit.

PROKURORIA: Kërkesa e Prokurorisë shoqërohet vetëm me relacion, asnjë dokument tjetër.

RISTANI-perfaqesues se prokurorisë e Përgjithshme: Unë e kuptoj që nën presionin e Metës ju këtë qëndrim do të mbani Thuhet se kërkesat nga Belgjika kanë ardhur që në janar. Jeni në dijeni të këtij fakti

PROKURORIA: Informacioni është konfi-

dencial.

VISHAJ: Nëse ka pasur urdhër arresti, deri më 22 shkurt 2015 kemi lëvizur lirish në zonën Shengen, që do të thotë që s’ka urdhër arresti ndërkombëtar. Edhe ne kërkojmë të njihemi me këtë urdhër, që të realizojmë mbrojtjen ligjore se nuk kemi ardhur formalisht këtu.

ISLAMI: Ka ardhur një kërkesë nga Belgjika, ka pasur kërkesa të mëparshme? Dhe nëse po kur?

PROKURORIA: Jo nuk ka pasur.

ISLAMI: Ju e keni marrë në datë 27 nga Interpol Tirana dhe në 28 nga Ministria e Drejtësisë. Ka mjaftuar kaq pak kohë për të studiuar dosjen?

PROKURORIA: Materiali që vjen nga Interpoli është urdhër i kërkimit ndërkombëtar, nuk është material jo shumë voluminoz.

ISLAMI: Ka një datë kur është lëshuar ky urdhër?

PROKURORIA: Dhe data është sekrete, është pjesë e urdhrin.

ISLAMI: Ka një proces gjyqësor që lidhet me një vrasje të ‘99. Gjykimi i parë është bërë në 2010, është ankimmuar, prokuroria do vazhdojë hetimet për këtë ngjarje? Apo do vazhdojë procesi i nisur në Belgjikë?

PROKURORIA: Në momentin që prokuroria merr një urdhër-arrest ndërkombëtar, dhe s’kemi marrëveshje ekstraditimi, do hetojmë edhe ne. Nuk është vetëm ai.



Procedura

Miratimi për Starzimirin në Këshill do kalojë në seancë

PD ka kërkuar me ngulm pjesëmarrjen në Këshillin e mandateve të Gent Starzimirit për të plotësuar vendin e saj vakant, i cili qëndron i tillë që në kohën kur u nda ga jeta deputeti demokrat Sokol Olldash. Megjithatë pavarësisht kërkesës kreu i Kuvendit Meta, iu ka bërë të ditur deputetëve të opozitës se kjo çështje duhet të kalojë më parë në seancë plenare, duke iu kujtuar atyre se kanë patur kohë pothuajse një vit për ta bërë këtë kërkesë dhe nuk e kanë bërë. “Keni një vit që e keni vendin që duhet ta kishit zëvendësuar dhe askush nuk ju ka ndaluar. Dje e keni çuar kërkesën për Strazimirin, të enjten do ta njoftoj në seancë dhe të premtën ai fillon punë si anëtar i këtij komisioni”, tha Meta.



Emri i rremë

Në faqen e interpolit janë publikuar dhe emrat e rremë që përdorte Frroku në Belgjikë, duke përfshirë dhe atë të Besnik Morinës. Ky emër përfshirë dhe emrin e saktë Mark Frroku prej tre muaj qëndron në listën e kuqe të kërkimit.

Avokatia e Frrokut

Mark Frroku u arrestua dhe u lirua brenda një muaji

Në një intervistë telefonike për "Top Channel", avokatja mbrojtëse e Mark Frrokut në Belgjikë, Carine Couquelet, hedh dritë mbi ngjarjen e ndodhur në vitin 1999 në Bruksel, për të cilën akuzohet deputeti Frroku, si dhe mbi provat që disponon prokuroria belge për këtë ngjarje.

"Është një histori shumë e vjetër e marsit 1999 dhe në 2004 klienti im është arrestuar këtu në Belgjikë për këtë çështje dhe pas dy muajsh, drejtësia belge e lironi atë pa asnjë kusht. Kjo do të thotë, sipas meje, që akuzat ishin shumë të dobëta, sepse kur ti lironesh pas dy muajsh nga burgu pa asnjë kusht, pa asnjë akuzë, do të thotë që akuzat ishin absolutisht të dobëta. Nuk ka dëshmitar, nuk ka prova materiale. Klienti im ka thënë që

nuk ka qenë në atë kohë në Belgjikë. Ai ka qenë më parë në Belgjikë, por në kohën e kësaj ngjarje nuk ka qenë. Ai ka qenë në Shqipëri dhe këtë do t'ja provoj gjykatës. Ka vetëm një dëshmi anonime dhe nuk është e mjaftueshme për të dënuar një person"-thotë avokatja belge.

SHPLLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbarimore "616/A" shpk, shpall shitjen në ankand për pasurinë « Truall + Ndërtesë », me sip. 250 m², nga të cilat 165 m² ndërtesë, me numër pasurie 14/73, vol. 16, fq.34, zk.8582, me adresë Lagjia nr. 4, Pogradec.

Pasuria nxirret në ankand me vlerën fillestare 5.520.000 (pesë milion e pesë qind e njëzet mijë) Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 23.04.2015.

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjia nr.3, Rruga «Naim Frashëri», Pogradec ose të kontaktojnë në:

Numrin 069 72 51 504 ose

Në e-mail: shoqeria616a@gmail.com

KATËR urdhëra-arrestit pritet të ekzekutohen nga Policia e Tiranës. Pritet votimi në parlament i heqjes së imunitetit të deputetit Mark Frroku

DETAJET

ELTON QYNO
TIRANË

Gabimet ortografike në mbiemrin e Mark Frrokut duket se i kanë dhënë mundësi deputetit të PKD të qëndrojë i qetë dhe i lirë, duke mos u arrestuar nga askush. Autoritetet Belge kishin lëshuar urdhërin e arrestit ndërkombëtar për Mark Frrokun, por gjenralitet nuk kanë qenë të saktë, pasi emri i Mark Frrokut është publikuar nga zyra e interpolit me gjenralitetet "Mark FFroku" i lindur në Gjakovë. Lapsusi me dy "FF" dhe ditëlindja në "Gjakovë", ka futur në dilemë dhe autoritetet shqiptare për të kryer ekzekutimin e këtij urdhër-arrestit të lëshuar nga Belgjika. Por pavarësisht kësaj dhe përcudi të të gjithëve, ky urdhër-arrestit megjithëse me gabime ortografike është qartësuar nga Zyra e Interpolit Tiranës dhe Ministria e Drejtësisë, të cilat në 27 mars dhe 28 mars i kanë dërguar dy shkresa zyres së Marëdhënies me Jasthtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, duke njoftuar se deputeti, që dy ditë më parë ishte arrestuar për akuzën e "Deklarimit të rreme para prokurorit". Fill pas këtyre dy shkresave prokuroria ka nisur procedimin nr.2 penale kundër Mark Frrokut, duke e akuzuar këtë herë për akuzën e "Vrasjes me paramendim" kryer në bashkëpunim në dëm të shtetasit Aleksandër Kurti. Nga sa mësohet urdhëri i arrestit është lëshuar në datën 3 dhjetor 2014 ndërsa në 8 janar 2015 është publikuar listën e kuqe të Interpol.

E-MAIL TEK DIDI

Drejtori i zyrës së Interpolit Artan Bajraktari i vënë në dijeni nga autoritet belge për publikimin e emrit të Mark Frrokut në listë e kuqe të emrave në kërkim, mësohet të ketë njoftuar me një e-mail kryepo-

Urdhëri

3 dhjetor 2014

Pikërisht në këtë datë është lëshuar urdhër-arrestit nga prokuroria e Brukselit kundër deputetit Mark Frroku. Për gati një vit urdhëri ka qëndruar pezull për të shkruar më pas në Interpol.

Publikimi

8 janar 2015

Në janar të 2015 pas një qëndrimi të gjatë pezullimi, urdhëri i arrestit është publikuar në faqen e interpolit, ku veç emrit me gabime ortografike janë dërguar dhe gjurmët e gishtave.

Shenjat

Tetë gjurmë

Në urdhërin e ndalimit të Interpolit, janë stampuar dhe 8 gjurmë gishtash të deputetit Mark Frroku. Pavarësisht lapsusit në emër, shenjat e gishtave të Frrokut nuk janë verifikuar.

Dy gabimet e belgëve që shpëtuan nga arresti Frrokun

Urdhëri i ndalimit një vit pezull, në 8 janar u publikua në faqen e Interpolit

Id entiteti:	2015/940	
Mbiemri:	FRROKU	← FFRROKU
Emri:	MARK	
Datëlindja:	1972/10/06	
Seksi:	M	
Vendlindja:	GJAKOVE	
Identiteti i konfirmuar:		
Shteti i lindjes:		
Gjurmë gishtash:	Te disponueshme	
Herën e fundit ndryshuar ne ICS:	2015/03/28	
Rishtuar ne ICS me:	20200107	
Klasifikimi:	CRIMINAL	
Tabat:		
Nena:		
Shtetesi:	Albania	
Statusi:	WANTED Purpose ARREST	
Pradhamerime:		
Histori ke:		

● Dokumenti i Interpolit, ku mbiemri është shënuar gabim me dy FF dhe vendlindja është gabim

licin Artan Didi. Ky i fundit nuk dihet se çfarë përgjigje ka kthyer, por mes tyre nuk ka pasur asnjë korrespondencë me dokumenta zyrtarë por vetëm e-mail. Në faqen e interpolit janë publikuar dhe emrat e rremë që përdorte Frroku në Belgjikë, duke përfshirë dhe atë të Besnik Morinës. Ky emër përfshirë dhe emrin e saktë Mark Frroku prej tre muaj qëndron në listën e kuqe të kërkimit, por në fakt zyra e Interpolit dhe Policia e Shtetit nuk kanë marrë asnjë masë për arrestimin e deputetit Frroku, duke menduar se gjenralitetet e dhëna nga drejtësia belge kanë qenë të gabuara.

4 URDHËR-ARRESTET

Me heqjen e imunitetit të deputetit Mark Frroku dhe marrjen e autorizimit nga parlamenti për vijimin e ndjekjes penale, mësohet se Prokuroria e Përgjithshme do të lëshojë katër urdhër-arreste, duke kërkuar Policisë së Shtetit të arrestojë Mark Frrokun, Besnik Vukën, Lek Bib Dafa dhe Arjan Bytycin. Veç Frrokut që ndodhet në Shqipëri, momentalisht me masën e sigurisë "arrest në shtëpi", mendohet se dhe tre bashkëpunorët e tij fshihen në Shqipëri dhe nisur nga këto indicie Prokuroria e Përgjithshme do të kërkojë arrestimin edhe të tre personave të tjerë që kanë qenë bashkë me Frrokun në vrasjen e Kurtit. Kërkesa për ndalimin e tyre, pritet të finalizohet vetëm pasi Këshilli i Mandateve të ketë urdhëruar heqjen e imunitetit të Mark Frrokut dhe autorizimin për vijimin e ndjekjes penale.

Masa e sigurisë

Bajraktari dhe Alla brenda 24 orëve në gjyq



Artan Bajraktari

— Shefi i zyrës së Interpolit Tiranës Artan Bajraktari dhe specialistja e kësaj zyre Laurëta Alla janë proceduar penalisht nga njësi hetimore Task-Forcë pranë prokurorisë së Tiranës. Bajraktari gjatë ditës së djeshme është marrë në pyetje ku ka deklaruar se për këtë rast kishte informuar shefat e tij, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Pritet që brenda 24 orëve Bajraktari dhe Laurëta Alla të dalin para gjykatës së Tiranës, ku do të njihen me masën e "arrestit në burg" që do kërkojë prokuroria e Tiranës.

MEDIAT italiane raportojnë se Ceka i ka premtuar kryetarit të Bashkisë në ishullin Ischia, Giosi Ferrandino vota të emigrantëve në Itali për llogari të tij

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Diplomacia shqiptare ka pësuar një goditje të rëndë ditën e djeshme, ku ambasadori i Shqipërisë në Romë, Neritan Ceka është përfshirë në një skandal korruptiv. Prestigjiozja italiane "La Stampa", në një artikull të publikuar ka denoncuar një skandal të blerjes së votave në të cilin, sipas saj është përfshirë edhe ambasadori shqiptar Neritan Ceka i cili premtojte votat e emigrantëve shqiptarë. Sipas gazetës italiane, Ceka i ka premtuar kryetarit të Bashkisë në ishullin Ischia, Giosi Ferrandino vota të emigrantëve në Itali për llogari të tij. Ky fakt, raporton gazeta italiane është zbuluar pas disa përgjimeve të cilat nisnin nga marsi i vitit të kaluar kur dy persona, Francesco Simone e Nicola Verri, i pari përgjegjës për marrëdhëniet e jashtme të CPL (kooperativë shërbimesh) dhe i dyti menaxher komercial në Lacio, la Campania dhe Sardenjë, të cilët diskutojnë si të financojnë shoqata dhe fondacione të lidhura me politikën. "Unë preferoj t'i jap 25 mijë euro italianëve evropianë të D'Alemas, që është gati të bëhet komisioner evropian. D'Alema zhyt duart e tij në m*t ashtu siç bëri me ne dhe na dha gjërat", i thotë Simeone-Verri, sipas përgjimeve të prokurorëve italianë. Kryetari i komunës i arrestuar, Giosi Ferrandino, në zgjedhjet e fundit për Parlamentin Europian kishte 82 301 vota, e për të siguruar një vend ndihmohet Francesco Simone. Përgjimet ambientale që i janë bërë këtyre shtetasve kanë faktuar se Simone kishte miqësi me ambasadorin shqiptar në Romë, Neritan Ceka dhe se kishin rënë dakord për të blerë vota për kryetarin Giosi Ferrandino, i cili po tentonte të zgjidhej për në Parlamentin Europian. Sipas përgjimeve, Simone telefonon kryetarin e komunës, Ferrandino dhe i tregon atij se ai është duke folur vetëm për shqiptarët me nënshtrësit italiane që votojnë për zgjedhjet evropiane. "Janë tridhjetë mijë vota. 10 mijë vota dalin gjithsesi, prit po të kaloj ambasadorin, kështu e fton deri në Ischia",

Skandal në Itali, Ceka bën pazare me votat e shqipëtarëve

Mediat italiane përgjojnë ambasadorin shqiptar në Romë, pazari për kryebashkiakun e Ischias

thotë ai. Më 14 shkurt, në bazë të hetimeve dhe përgjimeve Simone organizoi një drekë në restorantin "Grazia Deledda" në Romë për të folur për investimet në Shqipëri. Prestigjiozja italiane raporton se gjatë takimit mes tyre ka telefonuar, kryetari i Bashkisë Ferrandino dhe i

tregon atij se është me Cekën, me të cilin po flet pikërisht vetëm për shqiptarët me nënshtrësi italiane që votojnë për zgjedhjet evropiane: "Po, po, por ata janë shqiptarët që jetojnë tani në Itali prej 15 vjetësh dhe kanë nënshtrësinë italiane, ne fillojmë me ..." "Sa shqiptarë janë"

pyet Ferrandino. "30 mijë janë, kuptohet të gjithë ata që votojnë në Itali tashmë", përgjigjet Simone. Ceka qëndron në detyrë pavarësisht se kryeministri Rama ka kërkuar pezullimin e tij nga detyra pak muaj më parë, dekret i cili është refuzuar nga Presidenti Nishani.

"Veshi"
Në një takim në Romë të kryeministrit Rama gjatë kohës që ai ishte në opozitë, mediat folën për një skandal, pasi djali i ambasadorit Ceka pretendoi se Rama e kapi atë për veshi në takim



● Faksimile e artikullit të publikuar në gazetën italiane "La Stampa" në të cilën përfshihet edhe ambasadori shqiptarë në Romë, Neritan Ceka




Neritan Ceka

Përgjimi
"Unë preferoj t'i jap 25 mijë euro italianëve evropianë të D'Alemas, që është gati të bëhet komisioner evropian. D'Alema zhyt duart e tij në m*t ashtu siç bëri me ne dhe na dha gjërat", i thotë Simeone-Verri, sipas përgjimeve të prokurorëve italianë"

Përgënjeshtrimi
Ambasadori Neritan Ceka menjëherë pas publikimit të skandalit mësohet se ka dërguar një letër në të cilën ka kërkuar përgënjeshttrimin e artikullit. Ceka ka kërkuar nga media italiane korigjimin e e artikullit duke pretenduar se se nuk e ka takuar asnjëherë ish-kryetarin e Ischia, Ferrandino duke mohuar të ketë folur me të për vota të shqiptarëve. Ceka kërkon përgënjeshttrim me pretendimin se është prishur imazhi i shqiptarëve

AKUZA
PD: Rama mbështet të inkriminuarit, në krah të Ndokës



— Takimi i djeshëm në Lezhë, ka shërbyer si argument për Partinë Demokratike për të akuzuar kryeministrin Rama për mbështetjen e personave të inkriminuar. Fakti që pjesë e takimit të djeshëm në Lezhë ishte edhe deputeti Arben Ndoka, është përdorur nga demokratët. PD e cilësoi deputetin Ndoka si simbol të kriminalizimit të parlamentit pasi ai është i dënuar me 7 vite burg në Itali për trafik prostitucioni. Ndërkohë sipas Ramës, "VajmedetPD është një maskë që bie sa herë vajmedeti i Shqip hap gojë kundër Policisë... pra 2 herë në ditë."

Makoveit

Apel politikës, të inkriminuarit të ikin nga pozicionet publike

Dekriminalizimi është çështja kryesore që Bashkimi Europian ka përcaktuar si kriter për ecurinë e vendit në hapat integruese. Edhe një herë dje në emër të BE, kryetarja e Komitetit për MSA-në BE-Shqipëri Monika Makovei i ka kërkuar politikës të largojë të gjithë njerëzit me të dhëna kriminale që janë në pozicione publike. Këta persona sipas saj, duhet të japin dorëheqjen. Makovei u shpreh se prokurorët duhet të lejohet të hetojnë akuzat, pavarësisht partisë politike ku janë të përfshirë. Eurodeputetja thotë se interesat e Shqipërisë dhe popullit shqiptar janë përtej çdo partie politike apo interesave individuale. Duke kujtuar takimin e fundit në Tiranë, Makovei u bën thirrje partive politike të dialogojnë. "Ne

punojmë për popullin shqiptar, jo për partitë. Shqiptarët duan futjen në BE, sepse kjo sjell një përmirësim në jetën e tyre, në shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, punë, dhe sektorin e shëndetit publik ndër të tjera. Për të siguruar të ndodhë kjo, politikanët duhet të mbeten të bashkuar sepse ky objektiv shkon përtej çdo pozicion politik. Ka raste në historinë e një vendi kur të gjitha palët duhet të veprojnë dorë më dorë për të arritur objektivat e jetike. Anëtarësimi i Shqipërisë në BE do të bëjë jetën më të mirë për të gjithë njerëzit", deklaroi eurodeputetja. Sipas saj, gjyqësori ka nevojë për një shkallë të lartë të profesionalizmit dhe pavarësisë. "Nuk ka institucione të mira, pa njerëz të mirë udhëheqës", deklaroi ajo.



Monika Makovei

» INTERVISTA

KËSHILLI Kombëtar i Integritimit, i cili do të drejtohet nga opozita dhe është miratuar nga Parlamenti, ka të gjitha mundësitë për të filluar dhe për të nisur së funksionuari

Gjoshja: Jemi herët për të kërkuar anëtarësimin në BE

“Me opozitën kemi këndvështrime të ndryshme por do bëhemi bashkë për procesin e integritimit”

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Ministrja e Integritimit European, Klajda Gjoshja e konsideron të papërgatitur vendin për të qenë pjesë e BE, ndërkohë që shprehet e bindur se qeveria do të përbushë detyrat për plotësimin e 5 prioritetëve. Në një intervistë për “Shqiptarja.com”, Gjoshja vlerëson tryezën e dialogut të lartë të zhvilluar pak ditë më parë mes Shqipërisë dhe BE, duke theksuar se më shpresëdhënëse nga ky takim ishte fakti që opozita dhe sinjalet e një bashkëpunimi me qeverinë për çështjen e integritimit.

Si e vlerësoni këtë raund të dialogut me BE dhe a mendoni se do të arrihet deri në vjeshtë të përmbyllet puna për plotësimin e prioritetëve?

Tryeza e dialogut të Nivelit të Lartë që ne zhvilluam në 24 mars, mund tju them me bindje të plotë që ishte një nga tryezat më konstruktive mes qeverisë, opozitës, institucioneve të pavarura dhe Bashkimit European. Ishte një tryezë ku secila nga palët pjesëmarrëse kishte zërin dhe hapësirën e saj. Ndryshimi i vetëm dhe do ta vlerësoja vërtet pozitiv, që nuk pati replika apo debate mes opozitës dhe ministrave, duke iu përmbajtur plotësisht qëllimit për të cilin mblidhet kjo tryezë: dialog për të parë mbarëvajtjen e 5 prioritetëve që Shqipërisë i janë lënë nga Bashkimi European, deri në hapjen e negociatave. Ne për herë të parë kishim Komisionerin Hahn në këtë tryezë, i cili ka një vizion mjaft pozitiv dhe ka shprehur mbështetjen e tij dhe të Komisionit për procesin e integritimit të Shqipërisë në BE. Në lidhje me përmshjen brenda vjeshtës së afatëve dhe masave të vendosura, jam e bindur se ne do të demonstrojmë me vepra që dimë tu përmbahemi afatëve dhe se jemi të vendosur që të çojmë përpara procesin.

Tryeza
Tryeza e Nivelit të Lartë e zhvilluar në 24 mars, ishte një nga tryezat më konstruktive mes qeverisë, opozitës, institucioneve të pavarura shqiptare dhe BE



Tiranë, e vinte theksin të bashkëpunimi që duhet të kenë mes tyre mazhoranca dhe opozita. Sa ndikim do të ketë kjo klimë e rënduar politike në përmbushjen e këtyre prioritetëve?

Unë e kam shprehur gjithnjë që opozita dhe mazhoranca duhet të jenë bashkë në këtë proces kaq të rëndësishëm dhe për hir të së vërtetës mendoj se janë krijuar të gjitha hapësirat që opozita të japë kontributin e



Klajda Gjoshja

saj. Këshilli Kombëtar i Integritimit i cili do të drejtohet nga opozita, është vetëm një tregues i kësaj hapësire, gjë që u pa mjaft pozitivisht nga Komisioni edhe në Tryezën e Dialogut të Nivelit të Lartë. Nga ana tjetër reformat janë indikator më i mirë për të matur si po shkon ecuria e 5 prioritetëve. Me opozitën mund të kemi këndvështrime të ndryshme për shumë çështje, por mendoj se jemi në një linjë sa i përket

rëndësisë që ka procesi i integritimit të Shqipërisë. Besoj dhe shpresoj shumë që ky proces mos përdoret politikisht, por të shihet si një proces që i shërben të ardhmes së gjithë shqiptarëve.

Besoni se në progres-raportin e rradhës që do të jepet për Shqipërinë do të jetë edhe rekomandimi për çeljen e negociatave për në BE?

Këtë e vendos Komisioni. Ajo që ne kërkojmë është vlerësimi mbi parimin e meritës, pra nëse Shqipëria ka plotësuar atë që i kërkohet nuk ka asnjë arsye pse ky rekomandim të mos jepet. Kjo është një kërkesë që ne ja kemi bërë Komisionit European, duke mbajtur parasysh parimin që sipërpërmenda.

Kur pritet të fillojë nga puna, Këshilli Kombëtar i Integritimit tashmë që mori edhe “bekimin” e Kuvendit dhe cilat do të jenë çështjet e para që do të jenë në axhendën e tij?

Mbledhja e Këshillit Kombëtar të Integritimit nuk është kompetencë e Ministrisë së Integritimit. Është një strukturë shumë e rëndësishme, e miratuar nga Parlamenti, dhe unë besoj se egzistojnë gjithë vullneti që sa më shpejt ky

Këshill të bëjë mbledhjen e tij të parë e të nisë së funksionuar.



Raporti
Ne kërkojmë nga KE që të na vlerësojë mbi parimin e meritës, pra nëse Shqipëria ka plotësuar atë që i kërkohet nuk ka asnjë arsye pse ky rekomandim të mos jepet

Nga një studim i bërë rezultoi se 91% e shqiptarëve do të votojnë pro anëtarësimit të Shqipërisë në BE, por sa e gatshme është Shqipëria dhe politika shqiptare për ta hedhur këtë hap?

Me lejonin të theksoj se integritimi është

një proces që ka kohën dhe fazat e tij. Pra nuk mund të ketë anëtarësim të një vendi, pa kaluar nëpër të gjitha hallkat e procesit. Mënyrë shqiptare, ka pak muaj që ka marrë statusin e vendit kandidat, nuk ka hapur ende negociatat me BE-në. Pra të flasësh për anëtarësim në këtë moment më duket diçka e papërshtatshme. Unë e kuptoj dëshirën e shqiptarëve, madje e vlerësoj këtë proeuropianizëm që ne kemi, por të gjithë duhet të jemi të qartë, se pavarësisht dëshirës, duhet ende shumë punë që ta shohim vendin tonë anëtarë me të drejta të plota në Bashkimin European.



AMERICAN COLLEGE OF THESSALONIKI



Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – SOROS dhe Kolegji Amerikan i Selanikut ftojnë gjithë të interesuarit të aplikojnë për bursa të plota dhe të pjeshme për studime universitare (BA) 4 – vjeçare në Kolegjin Amerikan të Selanikut, dhe për studime pasuniversitare Master një vjeçar, për vitin akademik 2015-2016.

Degët që ofrohen:

Në nivelin Bachelor

Administrim Bisnes (BS)

(me specializim në Finance, Biznes Ndërkombëtar, Menaxhim ose Marketing)

Mardhënie Ndërkombëtare (BA)

Biznes dhe Shkencë kompjuterike

Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA) (me specializim në Gjuhësi dhe Letërsi, ose Komunikim&Media)

Në nivelin Pasuniversitar :

Master në Administrim Bisnesi (MBA)

Kriteret : Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet që:

Për Studime Universitare BA :

- Të jenë nxënës në vitin e fundit të shkollës së mesme ose ta kenë përfunduar atë;
- Të kenë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze (Për këtë qëllim të gjithë aplikantët do t'i nënshtrohen testit të gjuhës angleze pranë zyrarëve të Fondacionit Soros).
- Aplikantët duhet të kenë një notë mesatare të lartë.

Për Studime Pasuniversitare

- Të jenë nxënës në vitin e fundit të Universitetit ose ta kenë përfunduar atë;

APLIKIMI

Ju duhet të aplikoni online në linkun : <http://admissions.act.edu/>

Afati për Studime Universitare 15 Maj 2015; Afati për Studime Master 30 Maj 2015

Gjithashtu duhet të plotësoni edhe Formularin e Ndhimës Financiare në linkun :

http://www.act.edu/financial_aid/finaid.jsp?par=FINAID1 – për studime universitare

dhe në linkun :

http://www.act.edu/financial_aid/finaid.jsp?par=FINAID2 – për studime Master

Dokumentacionin plotësues të Aplikimit duhet ta dorëzoni deri në afatet e treguara më sipër, pranë zyrarëve të Fondacionit Soros, në adresën e mëposhtme :

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros),

Rr. Qemal Stafa, 120/2, Tiranë

Tel: +355-42-235856, 248-213

e-mail: bursa@osfa.al

Ju mund të shkarkoni listën e dokumentacionit të kërkuar te faja www.osfa.al, ose të vini t'i tërhiqni ato pranë sekretarisë së Fondacionit SOROS.

Për më tepër informacion, Fondacioni SOROS dhe Kolegji Amerikan i Selanikut (ACT) ju ftojnë të merrni pjesë në SESIONIN INFORMUES që do të zhvillohet datë 2 Prill, ora 16.00, në ambientet e Fondacionit Soros në Tiranë.

www.act.edu

www.osfa.al

Një nga konkluzionet e KE për dialogun e zhvilluar në

» ZGJEDHJET REPUBLIKANËT i vendosin kushte kreut demokrat Basha, duke i kujtuar se PR-së i takon 20 % e bashkive në vend, duke rritur edhe presionin për kandidaturën e Dukës në Durrës.



Propozimi

Gjatë mbledhjes së strukturave të PR-së, mbledhje vetë Duka është shprehur se ka qenë Basha ai që i ka kërkuar kandidimin për bashkinë e Durrësit si kandidatura më e mirë që mund t'i siguronte fitoren të djathtë në këtë bashki.

Mediu i vendos kushte Bashës, kërkon 20% të Bashkive

PR i jep 10 ditë kohë PD për kandidimin e Dukës në Durrës

ERMIRA MRRUKU
TIRANË

Shthurja e së djathtës mesa duket nuk nje limitet, në këto kushte Partia Republikane vijon me qëndrimet e saj të prera ndaj liderit të Partisë Demokratike. Kështu kreu republikan Fatmir Mediu nëpërmjet një statusi në "facebook", ka vijuar t'iu qëndrojë deklaratave të bëra dy ditë më parë se kreu demokrat Basha duhet të jetë më i qartë në marrëdhënie me aleatët dhe konkretisht me PR-në. Ndërkohë që Mediu ka bërë të qartë se cilat janë kërkesat e republikanëve për marrëveshjen parazgjedhore, ndërsa ka theksuar se si parti në koalicion mbi bazë të rezultateve të zgjedhjeve lokale paraardhëse PR-së i takon që të përfaqësohet në zgjedhjet lokale me 20% të bashkive. Në këtë mënyrë kreu republikan i vendos kushtin e radhës kreut demokrat Lulzim Basha, i cili pritet që t'i mbledhë aleatët ditën e sotme në orën 17:00. Më tej kreu i PR-së, Mediu bën me dije se si parti aleate në opozitë, nga ana e tyre nuk është imponuar asnjë kandidaturë për zgjedhjet lokale të 21 Qershorit, por bën me dije se PR-ja ka ofruar Agron Dukën si kandidaturë për Durrësin. "Kemi ofruar kandidatë të cilët mendojmë se kanë shan-

set për të fituar në emër të opozitës dhe kemi vlerësuar maksimalisht që një pjesë e tyre kanë qenë të propozuar nga vetë Partia Demokratike, siç është rasti i Z.Duka. Nëse nisemi nga praktikë e mëparshme të koalicioneve dhe parimet të proporcionalitetit, ne atëherë duhet të kërkonim të kandidonim bazuar në rezultatit e zgjedhjeve të fundit lokale me rreth 20% të bashkive", shkruan Mediu.

ULTIMATUMI

Partia Republikane i ka dhënë një

ultimatum kreut demokrat dje pas mbarrimit të mbledhjes së strukturave më të larta të kësaj force politike, duke i vënë në dispozicion 10 ditë kohë për të vendosur për kandidaturën e Agron Dukës për bashkinë e Durrësit. Në një deklaratë për mediat, nënkryetari republikan Arian Madhi, është shprehur se deputeti Duka është kandidatura me potenciale, që mund t'i sjellë fitoren e së djathtës, gjë të cilën e nënvizoi edhe kreut i PR-së Mediu para dy ditësh. Më tej nënkryetari republikan theksoi se gjithçka për kandidaturën e Dukës si fitues në zgjedhjet lokale mbështet mbi sondazhet që janë bërë të ditur nga vetë PD-ja. "Partia Demokratike ka vlerësuar kandidaturën e zotit Duka si një kandidaturë jashtëzakonisht e përshtatshme dhe në sondazhet që vetë i ka bërë deklarativë Partia Demokratike, zoti Duka vlerësohet si një kandidat fitues", tha Madhi. Më tej nënkryetari republikan theksoi se PR ka vendosur që brenda 10 ditëve Asambleja Kombëtare do të vendosë mbi propozimet që ka kjo forcë politike për 61 bashkitë e vendit. "Asambleja Kombëtare brenda 10 ditëve të vendosur, bazuar mbi propozimin e kryesisë për kandidatë për kryetare bashkie dhe këshilltarë të PR që do të garojnë në 61 bashki. Shpreh vullnetin dhe angazhimin e saj me çdo faktor politik i cili orientohet nga parimet e bashkëpunimit transparent", u shpreh ai.



Nënkryetari i PR Arian Madhi


Paralajmërimi

"Ne nuk do të dëshironim shanset që PD të merrte një vendim e cila do të anashkalonte peshën politike dhe marrëdhëniet me çdo parti tjetër aleate", theksoi Arian Madhi.



Kreu i PD Lulzim Basha dhe kreu i PR Fatmir Mediu

REAGIMI



Bashkia: Rama betonizoi Tiranën në 11 vjet

Bashkia e Tiranës ka reaguar pas akuzave të Partisë Socialiste, ku thuhet se kryebashkiaku Basha nuk ka mbajtur 22 premtime të dhëna në fushatë. Në reagimin e saj Bashkia e Tiranës akuzon kryeministrin si gënjeshhtar dhe si personin i cili ka kriminalizuar pushtetin. Sipas Bashkisë, Rama pasi betonizoi për 11 vite Tiranën ka bllokuar projektet urbane të kryeqytetit nga xhelozia. "Betonizoi Tiranën për 11 vite është sot kryeministri që ka kriminalizuar pushtetin", thuhet në reagimin e bashkisë.

DEKLARATAT

Basha: S'kandidoj për Tiranën, do të drejtoj opozitën

Tërheqja e Bashës, PS: I kurseu vetes ndëshkimin me votë

Kreu demokrat Basha, zyrtarisht nuk do të kandidojë për Bashkinë e Tiranës në zgjedhjet lokale të 21 qershorit, këtë e deklaroi vetë ai, ndërsa inaguroi ndërtimin e një kopshti në kryeqytet. Kreu demokrat u shpreh se Basha pranoi se do të drejtojë opozitën për të rritur qeverinë, që e cilësoi si qeverinë e lakut në fyt. Ndërsa dekalroi se me këtë vendim i qëndron bindjes së tij dhe asaj që ka thënë katër vite më parë, kur vendosi t'i përkushtohej Tiranës, që bashkisë i duhet një kryetar më kohë dhe përkushtim të plotë, ndërkohë



Lulzim Basha

që misioni i tij tashmë është në krye të opozitës, për largimin e qeverisë. "Katër vjet më parë kur unë u përballa me Edi Ramën për Bashkinë e Tiranës kam shprehur një bindje se kryetari i opozitës nuk duhet të ri kandidojë për kryebashkiak. Misioni im tani është të drejtoj opozitën në largimin e qeverisë së lakut në fyt. E kam mundur për garën e Bashkisë, do ta mundim në garën për gjithë bashkitë dhe për qeverinë", deklaroi Basha. Ndërkohë, Partia Socialiste ka reaguar pas deklaratave të kryetarit të PD, Lulzim Basha se ky i fundit nuk do të garojë për zgjedhjet

lokale. Deputetja socialiste Blerina Gjylameti në një deklaratë për mediat tha se Basha nuk do të ishte kryebashkiak pa votat e shpikura nga Arben Ristani. Gjylameti tha se Basha me këtë vendim po i kursen vetes ndëshkimin e merituar me votë nga qytetarët e kryeqytetit që në këto 4 vite kanë parë sesi ka degraduar nga dita në ditë. "Basha po i kursen vetes ndëshkimin e merituar me votë nga qytetarët e kryeqytetit që në këto 4 vite kanë parë sesi ka degraduar nga dita në ditë hapësira e përbashkët ku ata kanë zgjedhur të jetojnë e të punojnë", u shpreh Gjylameti.

Rama-Meta**45 minuta kokë më kokë,
gati emrat për bashkitë**

— Kryeministri Rama dhe kryeparlamentari Meta kanë zhvilluar mëngjesin e djeshëm një takim 45 minutësh mes tyre në fokus të së cilët kanë pasur listat përfundimtare për zgjedhjet vendore. Takimi i djeshëm ka ndodhur pas nënshkrimit të marrëveshjes së kryeministrit Rama me kreun e PDIU-së, Shpëtim Idrizi dhe ftesës së hapur që i ka bërë partisë së ish-presidentit Bamir Topi. Sot dy liderët e koalicionit të majtë kishin lajmëruar se do të lançonin emrat për 61 njësitë vendore por zhvillimi i sondazheve në disa qytete duket se do të shtyjë me pak ditë këtë prezantim.

Koalicionet

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANE

Kryeministri Edi Rama pasi përcaktoi fillimisht zonat në të cilat aleati Ilir Meta do të propozojë kandidatët e tij në zgjedhjet vendore është gati të dëgjojë kërkesat e kreut të PBDNJ-së Vangjel Dule dhe kreut të FRD-së, Bamir Topi. Negociatat që kryeministri do të zhvillojë me drejtuesit e dy partive pritet të zhvillohen brenda këtyre ditëve, pasi mazhoranca është e vendosur që të shpallë sa më shpejtë kandidatët e saj. Rama ka marrë mëngjesin e djeshëm edhe dakordësinë e aleatit në mazhorancës Ilir Meta për zhvillimin e këtyre negociatave, menjëherë pasi firmosi me kreun e PDIU-së Shpëtim Idrizin. Brenda kampit rozë, janë përcaktuar kandidatët që do të përfaqësojnë të majtën në zgjedhjet me përjashtim të Tiranës e cila vijon të mbetet në dilemë dhe të zgjidhet vetëm pas përfundimit të sondazheve të brendshme. Në takimet maratonë që kryeministri Rama ka zhvilluar dy ditë më parë me deputetët e tij, disa bashki janë "lënë në harresë". Këto njësi administrative janë pikërisht bashkitë që Rama pritet të diskutojë me aleatët e tij dhe krerët e partive që do të pranohet të bashkohen koalicionit të majtë në zgjedhje.

**Tahiri**

Deputeti i PDIU, Dashamir Tahiri ka vendosur të mos i përbahet marrëveshjes së nënshkruar mes kreut të partisë së tij dhe kryeministrit Rama, pa zhvilluar më parë konsulta me bazën. Të njëjtin qëndrim do të mbajë edhe deputeti tjetër Tahir Muhedini. Ndërkohë që dje deputetët në komisionet parlamentare janë shfaqur të ulur në karriget e opozitës, duke mos u ulur në krah të kolegëve të mazhorancës.

**RAMA****“Lames i ‘hanë duart’,
prandaj s’e kandidoj”**

— Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame nuk do të jetë kandidat i mazhorancës për Bashkinë e Tiranës. Ka qenë vetë kryeministri Rama i cili dje nga Lezha gjatë dhënies së certifikatave të pronësisë i është përgjigjur dhënies prej qytetarëve. Qytetari i ka kërkuar “një nder” Ramës, lidhur me dëshirën e bërë publike nga kreu i ALUIZNI-t për një kandidim të mundshëm për Tiranën. Megjithatë Rama është kthyer me humor duke u shprehur se “pikërisht se i hanë duart nuk do ta kandidojmë edhe ne”.

Rama zgjeron mazhorancën para zgjedhjeve, takon Topin e Dulen

FRD mbledh strukturat të enjten vendos për
aleancën, Dule gati ofertën për 3 bashki

për të Drejtat e Njeriut është një aleat i ynë dhe pjesëmarrës në qeverisjen e vendit”, deklaroi Rama. Kryeministri Rama dy ditë më parë bëri një ftesë publike edhe për kreun e Frymës së Re Demokratike,

Bamir Topi. Sipas kryeministrit, pjesëmarrja e FRD-së në koalicionin e majtë do të ishte një vlerë e shtuar. “Ka ende vend për të tjerë zëra dhe të tjera përvoja. Këtu kam parasysh edhe Frymën

e Re Demokratike, që me shumë konsideratë do ta ftojta të konsideronte bashkimin në këtë rrugë, jo për të përputhur programet, por për të rritur spektrin e ideve dhe të alternativave për vendin”, u shpreh

kreu i qeverisë. Ka qenë pikërisht kjo deklaratë që ka detyruar FRD, të mbledhë Këshillin Kombëtar të saj ditën e enjte në orën 11:00 për të arritur në një vendimarrje mbi kërkesën e mazhorancës. Kreu i kësaj force politike, Bamir Topi ka dhënë sinjallet e parë gjatë këtyre ditëve se mund të ketë një bashkëpunim me mazhorancën, duke mbështetur disa reforma të nisura prej saj. Mësohet se në rast të nënshkrimit të një marrëveshjeje me FRD, kryeministri pritet t’i lërë kësaj force politike



Vangjel Dule dhe Kryeministri Edi Rama



Edi Rama dhe Bamir Topi

PS-LSI

Kryetari i Partisë Aleanca Demokratike Eduard Abazi deklaroi dje se do të bashkohen koalicionit qeverisës. Vendim kreu i PAD-së, Abazi e ka argumentuar duke thënë se Shqipëria po ecën në drejtimin e duhur. Kjo forcë politike më parë ka qenë në drejtimin e Neritan Cekës.

propozimin për kandidimin e kryebashkiakut të Kamzës. Të njëjtat burime bëjnë me dije se FRD është gati të propozojë emrin e Ylli Shehut, si kandidat të përbashkët me mazhorancën nëse marrëveshja finalizohet.

SHPLLJE - ANKANDI PER SHITJE SENDI TE PALUAJTSHEM

Studio Ligjore Shërbim Përmbaruesi Gjyqësor Privat Eduard Allamani,
me adresë; Lagja Nr.2, Durrës

Në ekzekutim të Urdhër Ekzekutimi Nr.239(988),dt.13/06/2013, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, titullit ekzekutiv, kontratë – kredie Nr.332/1 kol,Nr.785 Rep, dt.30/03/2011, në lidhur midis palës kredidhënëse Fondi Besa Sh.a dhe kredimarrës Luan Cili dhe dorëzanes Lule Cili, zhvillohet ankandi i dytë me datë; 26 mars 2015 deri më datë 27 prill 2015 për shitje të pasurisë:

- me emërtimin trull + ndërtesë (garazh një kat me sip.20 m2), me Nr.pas.22/237, vol.16,fq.121,z.k. 8571, Lushnjë në pronësi të debitorit Luan Sabri Cili. Ankandi i dytë fillon me vlerën 470,400 lekë.



Ardian Bitraj

Kërkohet rikthimi i shumës prej 713 mld lekësh Vjedhja e thesarit, Banka e Shqipërisë padit të pandehurit

— Banka e Shqipërisë ka paditur në gjykatën e Tiranës tre të pandehurit e prokurorisë Ardian Bitraj, Kleves Bejtja dhe Mimoza Bruzia, të akuzuar për vjedhjen e 713 miliard lekëve nga thesari i shtetit. Padia civile është regjistruar në 30 mars të 2015 në sekretarinë e gjykatës së kryeqytetit, ndërkohë që objekti i saj është: "Detyrimin e të paditurve t'i kthejnë paditësit solidarisht dëmin e shkaktuar nga vjed-

hja në Departamentin e Emisionit të Bankës së Shqipërisë, në një vlerë prej 713.000.000 lekë". Pak kohë më parë gjykata penale nuk pranoi kërkesën e Bankës së Shqipërisë për tu bërë pjesë e procesit të gjyqimit penal, duke e autorizuar bankën që të vijonte gjyqin civil kundër tre të pandehurve. Bitraj, nipi i tij Kleves Bejtja dhe punonjësja tjetër e Thezarit të Shtetit Mimoza Bruzia janë cilësuar nga prokuroria si personat që

kanë vjedhur paratë nga arka e thesarit. Kjo shumë financiare është luajtur lloto dhe baste sportive nga Ardian Bitraj. Ky i fundit tashmë ka ndjerë pendesë për krimin e bërë dhe se ka pranuar gjykim të shkurtuar së bashku me shtetasen Mimoza Bruzia. Procesi gjyqësor ndaj tyre do vijojë në gjëndje të shkurtuar ndërkohë që për nipin e Bitraj, të pandehurin Kleves Bejtja gjyqimi do vijojë në gjëndje të zakonshme.

LAJME shkurt



Sot pritet vendimi për Arben Frrokun

— Pas 48 seanceve Gjykata e Krimeve të Rënda pritet të vendosë këtë të mërkurë nëse do të pranojë apo jo kërkesën e prokurorisë për dënim me burg për jetë ndaj Arben Frrokut, nën akuzë për vrasjen e ish-kryekomisarit Dritan Lamaj. Arben Frroku pritet të jetë vetë i pranishëm në seancë ku pas pretendencës së akuzës mbrojtja do të paraqesë pretendimet e saj, ndërsa seanca e kryesuar nga gjykatësi Dritan Halunaj nis në ora 9. Biznesmeni Frroku njëherazi vëllai i deputetit Mark Frroku asnjëherë se ka pranuar akuzën, ndërsa për prokurorinë provat, dëshmitë si dhe eksperimenti i kërkuar nga mbrojtja e Arben Frrokut kanë faktuar përfshirjen e të pandehurit në vrasjen e Lamajt shkurtin e 2013.

Apeli konfirmon pafajësinë e kryebashkiakut të Vlorës

Shpëtim Gjika deklarohet i pafajshëm nga gjykata

ELTON QYNO
TIRANE

Kryebashkiaku i Vlorës ka kryer shkelje administrative dhe jo penale. Ky është argumenti që gjykata e apelit ka përdorur në vendimin e saj, të dhënë ditën e djeshme për Shpëtim Gjikën. Veç kryebashkiakut të PS në Vlorë të pafajshëm janë shpallur nga gjykata e Apelit ish-vartësit e tij Eleni Dardhaj, vartësit tjetër Gentjan Sherifaj, si dhe të pandehurit tjetër Blerdi Liçaj. Në vendimin e gjykatës thuhet se "bazuar në tërësinë e provave të mara gjatë gjyqimit çmohet se veprimet apo mosveprimet e të pandehurve Shpëtim Gjika dhe Eleni Dardhaj, ballafaquar me elementët e anës objektive apo objektit të figurës së kriminit që kërkon figura e kriminit për të cilin janë akuzuar, jo vetëm që nuk provohen në tërësinë e tyre, por edhe ato që provohen përbëjnë shkelje me karakter administrative dhe jo penal, po të kemi parasysh dhe anën subjektive të kësaj figure krimini". Më tej gjyqtari Alaudin Malaj, argumenton se gjatë gjyqimit nga akuzat nuk u paraqit asnjë provë e drejt-përdrejtë që të vërtetonte faktin se në process-verbalet e mbledhjeve të KKRRT të datave 24 mars 2010 dhe 15 korrik 2010 janë bërë shtesa nga të pandehurit Shpëtim Gjika dhe Eleni Dardhaj në një kohë të mëvonshme. "Nuk provojnë falsifikimin e process-verbaleve as provat e tjera indirekte të paraqitura nga përfaqësuesit e akuzës, sikundër janë ato që pasqyrojnë lidhjen në një kohë të mëvonshme të kontratave të sipërmarjes midis pronarëve të truallit dhe subjekteve

Detajet

Shpëtim Gjika

Pas vendimit të Apelit, kryebashkiaku Gjika tha se "... sot foli drejtësisë, e prisja vendimin. Do të jem në bashki deri në ditën e fundit por tani nuk është momenti i duhet për të folur për rikandidimin".

Arrestimi

Pak kohë më parë prokuroria e Vlorës urdhëroi arrestimin e kryebashkiakut Shpëtim Gjika, i cili akuzohet për "Shpërdorim detyrë". Si pasojë e arrestimit, Gjika ka pasur probleme me zemrën e tij.

ndërtuese, as fakti që kërkesa për shesh dhe leje ndërtimi e pronarëve të truallit Mustafa Tartari, Aleks Ahmataj, Artan Ferhati me subjekt ndërtues Shqëria "Deco System" nuk është shqyrtuar më parë nga këshilli Teknik, si organ konsultativ i KRRT, as fakti se trualli ku do të ndërtoheshin pallatet në fjalë ka qenë parashikuar zonë e gjelbër, përdërisa kryetarit të KRRT, nuk i ndalohej të paraqesë këtij organi vendimarrës propozime të drejt-përdrejta për dhënie lejesh ndërtimi dhe përdërisa ky organ kolegjial i aprovon këto propozime"- argumenton gjykata në vendim e saj që i dha pafajësi 4 të pandehurve.



Shpëtim Gjika ne Gjykatën e Apelit

VIDEO/ GJYKATA E APELIT RËZON PROKURORINË



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

Prokuroria nuk tërhiqet

Akuza, rekurs në gjykatën e lartë për dënimin e Gjikës

— Megjithëse ka humbur të dyja betejat gjyqësore prokurorët e çështjes shprehën të bindur për fajësinë e kryebashkiakut Gjika. Sipas tyre, shumë shpejt do i drejtohet me një rekurs Gjykatës së Lartë, ku do kërkojnë deklarinim fajtor dhe dënimin e Shpëtim Gjikës dhe personave të tjerë. Në pretendencën e saj prokuroria ka kërkuar për Shpëtim Gjikën 4 vjet burg dhe 3 vjet heqje e të drejtës për ushtrimin e funksioneve publik, për Eleni Dardhaj-3 vjet burg dhe 3 vjet heqje

e të drejtës për ushtrimin e funksioneve publike dhe për Gentian Sherifaj-2 vjet burg si dhe për Blerdi Liçaj 2 vjet e 6 muaj burgim. Procesi penal ndaj Shpëtim Gjikës u zhvillua në Tiranë për shkak të presionit të vazhdueshëm në Vlorë dhe kushteve të papërshtatshme për të zhvilluar një proces gjyqësor të rregullt. Pas vijimit të gjyqimit në Tiranë Gjika u deklarua i pafajshëm nga gjykata vendim ky që u la në fuqi dhe edhe nga gjykata e Apelit Tiranë.



Kavajë iku nga burgu, pranga 25 vjeçarit

— Policia e Kavajës ka arrestuar një 25 vjeçar që ishte larguar pa leje nga vendi i vuajtjes së dënimin, ndaj të cilit ishte dhënë masa e arrestit me burg për vjedhje. Në prangat e policisë ka rënë Mario Biti, me banim në Plug të Lushnjës. Sipas policisë, në kuadër të finalizimit me sukses të operacionit të koduar "Plugu" është bërë i mundur arrestimi i 25 vjeçarit. Biti ishte shpallur në kërkim për veprën penale të "Largimit të burgosurit nga vendi i vuajtjes së dënimin i mbeur në tentativë e kryer në bashkëpunim". Kjo pasi ndaj 25 vjeçarit Gjykata e Kavajës kishte caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg". Materialet në ngarkim i kaluan Prokurorisë së Kavajës për veprimet e mëtejshme.

Djali vret me thikë babain, më pas tenton me komshien

Simon Prifti prej kohësh s'ishte në gjendje të mirë mendore

XHENSILA KODRA
TIRANE

Dëshmitë

Një 46-vjeçar është arrestuar nga efektivet e Policisë së Shtetit pasi akuzohet se ka vrarë gjatë mesnatës së të djelës babain e tij. Mësohet se viktimi është Pirro Prifti, 82 vjeç. Burime nga policia e Tiranës bëjnë me dije se autori i vrasjes është djali i tij Simon Prifti, 46 vjeç. Po ashtu, mësohet se ky i fundit ka qenë person me të meta mendore që në moshën 16 vjeçare. Sipas banorëve të lagjes në afërsi të "Shkollës së bashkuar", mësohet se Simoni jetonte i vetëm me babain e tij, pasi nëna kishte ndërruar jetë disa kohë më parë. Po ashtu, sipas komshinjeve, Simoni ishte djalë i vetëm i familjes Prifti, pasi ai nuk kishte motër ose vëlla.



Policia
Ende nuk kemi dijeni se kush janë familjarë të familjes Prifti, pasi ata jetonin vetëm të dy në banesë. Viktima ndodhet ende në morg deri në momentin që do të shfaqet një familjar i tij



Shtëpia e familjes Prifti

dhe ishte i pavetëdijshëm në vprimet që ai bënte.

RRËFIMI I KOMSHINJE

Të tronditur nga ngjarja se djali vret me thikë babain, komshinjtë shprehen se rreth orës 09:00 të mëngjesit të së hënës kanë parë 46 vjeçarin të dalë në lagje i mbuluar nga gjaku. Të shqetësuar nga pamja e tij, ata shprehen se menjëherë kanë hyrë në banesë dhe kanë parë trupin e pajetë të 82 vjeçarit Pirro Prifti të masakruar nga mes të shtëpisë. Në pamundësi për të lajmëruar familjarë të tij, banorët shprehen se menjëherë kanë telefonuar në Komisarariat numër 4 dhe kanë denoncuar ngjarjen e ndodhur. Po sipas tyre, edhe vetë policia e ka pasur të vështirë të vërë në pranga 46 vjeçarin, pasi në ato momente nuk ishte në një gjendje të mirë mendore. Ndërkohë, sipas burimeve të policisë, në cilësinë e provës material janë sekuestruar një thikë dhe një kazmë.



Banorët

Simoni fitonte para me pikturat që ai bënte. Secila prej tyre shitej me një shumë të konsiderueshme parash. Pamë se në shtëpinë e tij ndodhej edhe një shumë e madhe lekësh.

ishte diplomuar në kohën e duhur. Ishte pikërisht kjo edhe arsyeja pse 46 vjeçari nuk ishte në një gjendje të mirë mendore, pasi herë pas here kishte çrregullime

NGJARJA

Mesnatën e së dielës, në lagjen në afërsi të "Shkollës së bashkuar", një 46 vjeçar ka vrarë me thikë babain e tij. Sipas policisë, viktima është Pirro Prifti, ndërsa djali i tij Simon Prifti. Po sipas të njëjtave burime, bëhet me dije se denoncimi në Komisarariat numër 4 të Tiranës është bërë në orët e para të mëngjesit të së hënës. Mësohet se ka qenë fqinja e cila ka bërë denoncimin në polici, pasi baba e bir jetonin të vetëm në shtëpinë e tij. Të pyetur nga Shqiptarja.com banorë të kësaj zone shprehen se 46 vjeçari, Simon Prifti kishte vite që ishte në një gjendje jo të mirë mendore, por babai i tij nuk kishte dashur ta shtronte në ambientet e spitalit psikiatrik. Banorët shprehen se Simoni kishte studiuar për pikturë dhe nuk

Nasibeja:


'Simoni tentoi të më vriste edhe mua pas babait të tij'

— "Më vuri duart në fyt dhe tentoi të më vriste edhe mua". Ishin këto fjalët që një nga komshitet e Simon Priftit shprehu për Shqiptarja.com. Ishte pikërisht komshia, Nasibeja e cila kishte bërë edhe denoncimin në polici menjëherë pasi kishte parë 46 vjeçarin të endej nëpër lagje i mbuluar nga gjaku. Gjithashtu, ajo tha se kishte pasur edhe disa herë të tjera përplasje me Simonin në moment kur ky i fundit nuk ishte në gjendje normale. E shqetësuar nga ky fakt, Nasibeja theksoi se Simoni gjatë kohës që ishte në gjendje normale, kujdesej i vetëm për babain e tij.



NË FOTO: Nasibeja, komshia e Simon Priftit

LAJME shkurt



Tepelenë, maskat vjedhin 5 mijë euro

— Dy bashkëshortë të moshuar janë lidhur, dhunuar dhe grabitur mbrembjen e djeshme në lagjen "Demokracia" në Tepelenë. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 00:40 kur tre grabitës të maskuar e të armatosur kanë hyrë në banesën e Naim Cica 61 vjeç duke ushtruar dhunë ndaj këtij të fundit dhe bashkëshortes së tij A.C. 60 vjeç. Sipas policisë nën kërcënimin e armëve 3 grabitësit kanë vjedhur 5000 euro e më pas janë larguar në drejtim të paditur me një automjet tip Audi me targa CD 368 PT. Uniformat blu të Gjirokastrës kanë zbardhur ngjarjen dhe identifikuar autorët e dyshuar. Mësohet se tre të dyshuarit e shpallur në kërkim janë shtetasit S.J., 30 vjeç, A.J., 37 vjeç dhe shtetasi R.R., 31 vjeç, banues në Tiranë.



Bledar Pajana

"Mesit shqiptar", i konfiskohet pasuria

— Pasuria e bosit të kokainës Bledar Pajana, i cili njihet në Itali me pseudonimin edhe si "Messi i Shqipërisë" për shkak të ngjashmërisë me lojtarin e Barcelonës, është konfiskuar nga ana e autoriteteve të vendit fqinj. Lajmi bëhet i ditur nga mediat italiane sipas të cilave, Prokuroria e Breshias ka konfiskuar pasurinë e "Messit shqiptar" e cila arrinte në vlerën e rreth 1 milion eurove. Sipas mediave italiane, pasuria e bosit të drogës përfshin një kompani ndërtimi, një pronë banimi, disa llogari bankare si dhe makina luksoze. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se "Messi shqiptar" fshihej pas firmës së ndërtimit e cila në fakt prej kohësh nuk operonte.

Aksidenti fatal në Fier, vdes shefi i rendit të policisë Delvinë

Automjeti me shpejtësi të madhe, rëndë në spital pasagjeri



Një aksident rrugor ka ndodhur dje në Fier ku si pasojë ka gjetur vdekjen shefi i rendit të Delvinë si dhe është plagosur në gjendje të rëndë një person tjetër. Ngjarja ka ndodhur në rreth rrotullimit e Frrakullit, ku automjeti tip "Benz" me targa AA 437 EO ka dalë nga rruga. Për pasojë kanë mbetur të plagosur rëndë dy personat që po udhëtonin në

makinë, mes të cilëve edhe Shefi i Rëndit në Delvinë me iniciale P.B. Ky i fundit ka ndërruar jetë në spitalin rajonal të Fierit, ndërkohë personi tjetër Elton Xhemali është në gjendje të rëndë dhe po merr ndihmën e parë mjekësore. Nga të dhënat paraprake bëhet e ditur se automjeti po udhëtonte drejt Gjirokastrës ndërsa shkak i daljes së tij nga rruga ka

qenë shpejtësia tej normave të lejuara. Të njoftuar për këtë aksident të rëndë policia rrugore e Fierit ka shkuar në vendin e ngjarjes ku ka nisur punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të aksidentit. Momentalisht policia nuk ka bërë asnjë ndalim pasi edhe drejtuesi tjetër i mjetit që është përfshirë në këtë aksident ka marrë dëmtime të rënda dhe është në gjendje

kritike për jetës. Ekspertë të policisë rrugore të pranishëm në vendin e ngjarjes kanë kryer matjet të frenimit të automjeteve në rrugë, me qëllim nxjerrjen saktë të shpejtësisë me të cilët kanë ecur dy drejtuesit e mjetit. Në vendin e ngjarjes janë mbledhur dhe disa dëshmi të personave që kanë qenë të pranishëm gjatë aksidentit dhe të atyre që kanë dhënë ndihmën e parë



për dy personat e aksidentuar. Pritet që ditën e sotme ndaj efektivit të policisë së Shtetit të zhvillohen homazhe në banesën e tij.

186 procedime administrative, AKKP: Pronarët të paraqiten

Agjencia, shpallje publike me emrat e subjekteve të shpronësuar dhe kërkesve

LORENC RABETA
TIRANE

AKKP ka publikuar në faqen e vet zyrtare emrat e 186 pronarëve dosjet e të cilëve gjenden në proces verifikimi e shqyrtimi, por që nuk mund të kontaktohen nga institucioni. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit ka publikuar emrat e subjekteve të shpronësuar dhe të subjekteve kër-

ues të dosjeve në fjalë, të cilët nuk arrin t'i kontaktojë për t'i vënë në dijeni të procesit administrativ për dosjet e tyre. "Subjekti i interesuar për procedimin administrativ të sipërcituar ftohet të paraqitet menjëherë në Sektorin e Shqyrtimit për Qarqet Durrës, Korçë, Berat pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në adresën: Rruga "Muhamet Gjollështa", nr.54, Tiranë", specifikon një prej njoftimeve drejtuar pronarëve.

SUBJEKTET

"Shqiptarja.com" publikon sot emrat 186 subjekteve të cilët duhet të paraqitur në AKKP për t'u vënë në dijeni me procesin e shqyrtimit administrativ. "Duke qenë se në dosjen e mësipërme mungon një adresë e vlefshme që të mundësojë vënie në dijeni në këtë procedim administrativ të subjektit të interesuar dhe meqenëse njoftimi i subjektit është kthyer nga shërbimi postar, Agjencia e Kthimit



Drejtoresha e AKKP, Sonila Qato

dhe e Kompensimit të Pronave, për efekt komunikimi në bazë të nenit 6011, germa c;) të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 9235, date 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar dhe VKM nr.255, datë 13.04.2010 "Për procedurën e mbledhjes, përpunimit

dhe administrimit të akteve të subjekteve të shpronësuar, gjatë procesit të njohjes, kthimit apo kompensimit të pronës" lajmëron me anë të kësaj shpallje publike" thekson në njoftim AKKP ku bën publik gjithashtu edhe emrin e subjektit të shpronësuar dhe pretendues.

Fondi

Kompensimi financiar, verifikimet 3 muaj



■ Nga datën pesë janar deri më 5 shkurt 2015 Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave zhvilloi procesin e pranimit të kërkesave të pronarëve për shpërndarjen e fondit financiar prej 300 milionë lekësh të vënë në dispozicion nga qeveria për dëmshpërbimin e pronarëve. AKKP ka bërë me dije se janë paraqitur 1700 kërkesa dhe se verifikimi i tyre do të zgjasë tre muaj. Pritet që nga ky fond të përfitojnë afërsisht 100 pronarë.

AKKP ka publikuar në faqen e vet zyrtare emrat e 186 pronarëve në proces verifikimi

■ Abdulla Mullahi	■ Dashnor Hysi	■ Hamit Hasani	■ Luan Zoto	■ Pandeli Bollano	■ Shefqet Kananaj
■ Adem Jaup Dumbo	■ Ded Trieshi	■ Hamit Troka	■ Lumturi Toptani	■ Perparim Lana	■ Muharrem Kananaj
■ Adriatik Bakiasi	■ Dhimiter Agora	■ Hasan Curka	■ Lumturi Toptani	■ Petrit Veizi	■ Shjefen Nika
■ Agim Laci	■ Drita Lahi	■ Haxhire Nurce	■ Mahmut Dodgjin	■ Petrit Zikaj	■ Shkelqim Vasija
■ Agron Doja	■ Edmond Ndue Ndreu	■ Haziz Resuli	■ Maxhide Dibra	■ Petro Sevo	■ Sotiraq Papa
■ Albert Çelanj	■ Elez Cela	■ Hedije Bicaku	■ Mehmet Blogu	■ Qamil Dano	■ Spiro Varesi
■ Albina Marku	■ Elvira Shehu (Banka)	■ Hysen Cela	■ Mehmet Rexhep Isufi	■ Qani Veizi	■ Stefan Dano
■ Ali Çakaj	■ Emin Muharemi	■ Hyso (Hysen) Velaj	■ Muharrem Gjona	■ Qemal Haziraj	■ Llazi Dano
■ Ali Mileti	■ Emine Kaprcelli	■ Igli Pustina	■ Mujo Noka	■ Qerim Cela	■ Sulo Begaj
■ Ali Shehu	■ Engjëll Vrioni	■ Ilmi Topi	■ Mujo Noka	■ Ram Sulaj	■ Tas Bello
■ Ali Sofija	■ Jani Vrioni	■ Irena Laluci	■ Muke Kazizaj	■ Ramadan Burri	■ Marku Bello
■ Andrea Sterjo	■ Eqerem Nelaj	■ Islam Llapi	■ Musa Kuka	■ Ramadan Mahmut Elezaj	■ Tasim Spahiu
■ Anton Pjetrani	■ Fadil Haziraj	■ Ismail Beu	■ Musa Xhuveli	■ Rapo Seiti	■ Terezina Harapi
■ Ardian Tina	■ Fadil Sula	■ Ismail Ramazan Kruja	■ Mustafa Maze	■ Rasim Kovaci	■ Thodhori Kristo Noni
■ Arshi Shehu	■ Fadil Toptani	■ Jani Leka	■ Myftinia Lezhe	■ Refat Myqemeja	■ Familja Toptani
■ Avdyll Tobli	■ Fatmira Rushitaj	■ Jani Petani	■ Myrteza Zeneli	■ Reshit Skilja	■ Vasel Rrok Makaj
■ Azize Frasheri	■ Fet Sadik Gjoli	■ Jolanda Kabo	■ Myslym Cukaj	■ Rexhep Hasa	■ Vasilqi Koceno
■ Bade Dushku	■ Fiqiri Din Spahiu	■ Kalam Thomollari	■ Myzafere Shehu	■ Robert Kota	■ Vera Goxhaj
■ Bajram Hasani	■ Fiqiri Karina	■ Kamber Bytyci	■ Naim Mustafaj	■ Sadete Dedei	■ Vilasi Mocka
■ Bajram Noka	■ Fiqiri Spahiu	■ Sulejman Bytyci	■ Naim Mustafaj	■ Sadete Juka	■ Xhaharje Mekshi (Sejdini)
■ Ballkeze Mehmeti	■ Flamur Ali Hamza	■ Kasem Beja	■ Nase Xhaferaj	■ Sali Demaj	■ Xhako Jako Kokona
■ Bame Spore	■ Gani Lamce	■ Ketii Kurmaku	■ Nasta Dhima	■ Saqine Xhufi	■ Rasim Kokona
■ Banush Cela	■ Gani Osmani	■ Korab Bajraktari	■ Ndue Perjaku	■ Sefer Haziraj	■ Xhem Ahmetaj
■ Bashkim Dervishi	■ Garufi Dalla	■ Kosta Paco	■ Neshat Lutaj	■ Selam Myftar Selamaj	■ Sadri Ahmetaj
■ Bashkim Pinar	■ Lefter Dalla	■ Kristina Laze	■ Nesim Hodaj	■ Selfo Pashaj	■ Yson Ibrahimllari
■ Basri Elezi	■ Gëzim Xhelo	■ Kritsto Malo	■ Nezaqet Bala	■ Selim Bilali	■ Ymer Papinova
■ Basri Elezi	■ Gjelijina Colaj	■ Kujtim Memi	■ Nimet Balili	■ Selman Brinja	■ Zano Ahmetaj
■ Bibika Kokalari	■ Halil Tota	■ Lami Gjeka	■ Njazi Kuci	■ Shaban Hyka	■ Zef Gjeshok Çokaj
■ Dalip Halili	■ Hamdi Dervishi	■ Lejla Dervishi	■ Nushe Toskaj	■ Shahin Haxhijaj	■ Zef Shiroka
■ Dalip Meminaj (Ademaj)	■ Hamdi Dervishi	■ Leonora Stefani	■ Ollga Nikolla Malo	■ Shako Shakaj	■ Zenel Velia
■ Dalip Meta	■ Sheap Dervishi	■ Llesh Gjergji	■ Pal Pepa	■ Shane Bifsha	■ Zyni Mustafaj Lika

AEROPORTET

Inaugurohet linja direkte ajrore Tiranë-Paris

Haxhinasto: Aeroport i ri në Kukës dhe në jug të vendit

Shifrat e rritjes së qarkullimit të pasagjerëve në aeroportin e Tiranës janë gati 2.5 herë më të larta se mesatarja e industrisë evropiane, ndërkohë që është e afërt hapja e aeroportit të Kukësit dhe një tjetri në Jug të vendit. Deklarata është bërë dje nga Ministri i Transportit dhe Infrastruktura Edmond Haxhinasto mori gjatë ceremonisë së inaugurimit të fluturimit direkt Tiranë - Paris. Në hapjen e fjalës së tij Ministri Haxhinasto e vlerësoi hapjen e kësaj linje, si zhvillim të rëndësishëm në industrinë e aviacionit civil në Shqipëri dhe veçanërisht hapja e tregut që po reflekton cilësi më të lartë shërbimesh për qytetarët shqiptarë dhe kosto më të ulët. "Hapja e tregut në këtë 1 vit e gjysmë të fundit ka treguar qarte se kemi një ulje të çmimit të biletave deri në masën 30%": - tha ai. Ministri Haxhinasto cilësoi se linjat e reja direkte drejt Frankfurt, Paris dhe Bruksel përbëjnë rreth 10 %

në rritjen e lidhshmërisë të aeroportit të Rinast "Nënë Tereza" me destinacionet evropiane. Ai nënvizoi se është e rëndësishme të konsiderohet se sipas fakteve evropiane në këtë industri,



Haxhinasto në inaugurimin e linjës direkte të fluturimit Tiranë - Paris

kjo çështje ndikon në rritjen e GDP-së në masën 0.5 % për çdo banor.

AEROPORTET

Qëndrueshmëria e partneritetit me Tirana Inter-

Turizmi

Në planet tona, duhet të hyjë në funksion normal aeroporti i Kukësit, si dhe një aeroport i ri në jug të vendit, për t'i shërbyer kryesisht turizmit

Çmimet
Sipas Ministrit Haxhinasto, hapja e tregut në këtë 1 vit e gjysmë të fundit ka treguar qarte se kemi një ulje të çmimit të biletave deri në masën 30 përqind

national Aeroport u vlerësua i pozitive nga Ministri, por ai cilësoi si sfidë kryesore plotësimin e spektrit të shërbimeve në këtë aeroport. "Një fakt i mirëpritur është se shifrat e rritjes së qarkullimit të pasagjerëve në aeroportin e Tiranës janë gati 2.5 herë më të larta se mesatarja e industrisë evropiane. Ndërkohë që kemi akoma shumë për të bërë për të plotësuar spektrin e shërbimeve në këtë aeroport. Nuk kemi ende prezente kompanitë e fluturimit lowcost, ende nuk kemi targetuar segmentin e turistëve dhe akoma nuk kemi arritur nivele të kënaqshme në shërbimet kargo" - tha ai. Haxhinasto shtoi gjithashtu se Shqipëria i duhen aeroportet të reja, me qëllim të zhvillojnë ekonominë e veçanërisht sektorin e turizmit dhe se "në planet tona, duhet të hyjë në funksion normal aeroporti i Kukësit, si dhe një aeroport i ri në jug të vendit, për t'i shërbyer kryesisht industrisë së turizmit".

LORENC RABETA
TIRANE

Kryeministri Edi Rama mori dje pjesë në përrimin e qendrës së qytetit të Lezhës, ku dhe shpërndau certifikata të pronësisë me moton e legalizimit falas. Kryeministri Rama gjatë fjalës së tij, u shpreh se "Tani është hapur një kapitull i ri për legalizimin falas dhe sot me krenari për këtë hap të parë do të bëjmë që ekonomia familjare nga një strehë që nuk ekziston askundi, t'a kthejmë në pasuri të patundshme dhe si një mundësi për ta patur garanci në banka për të bërë biznes në bujqësi apo blegtori apo mbështetjen e fëmijëve në studime. Pra, nga kapitale të vdekura do t'i kthejmë në kapitale aktive dhe çdo shpenzim që kane bërë qytetarët i kanë të regjistruar si kapitale", tha Rama gjatë ceremonisë. Kreu i Qeverisë theksoi gjithashtu se "është kënaqësi që bëjmë takimin në këtë vepër të madhe publike të ndërtuar pas shumë vitesh, pasi ishte shndërruar në një parking makinash dhe ne vetëm në një vit bëmë ndryshime të dukshme në zemër të qytetit dhe në katër vitet e ardhshme me përfaqësuesin tonë që ju do të zgjidhni ne do të bëjmë më shumë nga sa është bërë për 25 vite". Legalizimet Zyra e ALUIZNI-t në Lezhë organizoi dje shpërndarjen e lejeve të legalizimit për banorët e kësaj zone, me praninë e kryeministrit Edi Rama, Ministres së Zhvillimit Urban, Eglantina Gjermeni, Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, Artan Lame, deputetë të zonës dhe drejtues lokalë. Zyra e ALUIZNI-t në Lezhë është hapur në mars të vitit që shkoi dhe për një vit punë ka arritur të përgatisë më shumë se 1800 leje legalizimi për qytetarët e kësaj zone, në raport me rreth 1300 leje legalizimi të shpërndara në 8 vite të qeverisjes së shkuar. Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame, gjatë fjalës së tij preku çështjet problematike

Rama në Lezhë: kapitull i ri për legalizimin falas

"Nga kapitale të vdekura do kthejmë në kapitale aktive çdo shpenzim që kane bërë qytetarët"



Ceremonia

Zyra e ALUIZNI-t në Lezhë organizoi dje shpërndarjen e lejeve të legalizimit me praninë e kryeministrit Edi Rama, Ministres Gjermeni e kreut të ALUIZNI-t Artan Lame

që prekin këtë qark që nga zonat turistike deri tek zona historike të mbrojtura. "Ishte gati qesharake situata

atëherë sepse nuk kishte akoma as zyrë të ALUIZNI-t në Lezhë dhe jemi detyruar ti ngjimis njerëzit tek shkollat e Bibliotekës për të dhënë lejet e para. Por ishte një premtim i madh për situatën e mëtejshme. Qarku i Lezhës i përmbledh edhe fushën edhe malin, edhe problematikën turistike dhe varfërinë që ndërthet shumë fort me procesin e legalizimeve. Kjo ka bërë që të

Lezha

Legalizimet

Tani është hapur një kapitull i ri për legalizimin falas dhe sot me krenari për këtë hap të parë do të bëjmë që ekonomia familjare nga një strehë që nuk ekziston askundi

Kapitalet

Nga kapitale të vdekura do t'i kthejmë në kapitale aktive dhe çdo shpenzim që kane bërë qytetarët i kanë të regjistruar si kapitale, tha Rama gjatë ceremonisë

ketë shumë probleme si qark dhe tipologji të ndryshme për tu përballuar" tha para qytetarëve kreu i Agjencisë Artan Lame.

DRAFTI

Komisioni, debate për taksën e karburanteve



Komisioni i Ekonomisë diskutoi dje projektligjin e propozuar nga deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku për ulje e taksës së qarkullimit të karburanteve. I pranishëm në komision gjatë shqyrtimit të p/ligjit ishte ministri i Financave Shkelqim Cani. Deputetja e Partisë Demokratike Jorida Tabaku tha se, në Shqipëri nuk u reflektua ulja e çmimit në tregjet ndërkombëtare si pasojë e taksave. "Rritja e taksës së qarkullimit në 27 lekë për këtë vit ka ndikuar ndjeshëm në çmimet e naftës që janë edhe më të larta në rajon", theksoi Tabaku, ndërsa kërkoi edhe uljen e taksës së qarkullimit në nivelin e mëparshëm. Ndërkohë gjatë fjalës së tij në Komisionin e Ekonomisë, ministri Cani u shpreh se ky është një propozim politik nga ana e opozitës. "Kjo kërkesë ka ndikim në buxhet me rreth 12 miliard lekë, e për këtë arsye duhet të sillin edhe ndryshimet përkatëse në buxhet, sepse nuk mund të rrisim akoma borxhin", theksoi ministri Cani.

Fondi i sigurimeve ja sa janë ulur çmimet e barnave

Hyn në fuqi lista e barnave të rimbursueshme, kategoritë që përfitojnë. Si funksionon receta 2-mujore

DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Nga sot hyn në fuqi lista e re e barnave të rimbursueshme. Për vitin 2015 janë shtuar 29 barna të reja, ku zgjerohen shërbimet në fusha si Onkologjik, Gastrohepatologji, Pneumologji, Reumatologji, Infektiv, në terapinë kardiake, Parkinson, etj. "Risja e këtij viti është rimbursimi i materialeve mjekësore. Falë ligjit të ri të FSDKSH, tashmë kemi hapë-

sirat ligjore për të rimbursuar edhe materiale mjekësore, për të cilat ka patur kërkesa të vazhdueshme në Fond nga popullata në nevojë. Ne do të bëjmë të mundur këtë vit edhe rimbursimin e materialeve mjekësore, siç janë strishat për diabetikët, aq të nevojshme për të mbajtur nën

Receta 2-mujore

Pacientët, sidomos pensionistët që janë dhe përfituesit kryesorë, do të kenë një lehtësim të ndjeshëm, pasi nuk do ta kenë të nevojshme paraqitjen pranë mjekut të familjes çdo muaj për barnat që marrin për rimbursim

kontroll sëmundshmërinë, e për pasojë, për të patur një mjekim efikas e cilësor për pacientët, qeset njëpërdorimshme për shkarkimin kolostomik, disa pajisje për kardiologjinë invazive, etj", - thuhet në një njoftim të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Rimbursimi i

materialeve mjekësore bëhet i mundur edhe falë uljes së çmimeve të barnave. Vendimi i Këshilli të Ministrave nr 645, datë 1.10.2014 për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Çmimit të Barnave përcaktoi qartë këtë vit se, çmimi i barnave duhet të jetë i krahasueshëm me



Barnat që shtohen në listën e rimbursimit 2015

Principe të reja aktive		
Emërtimi Kimik	Forma	Shërbimi ku përdoret
Lactuloze 667 g/1L - 200ML	flakon	gastro-hepatologjia
Sofosbuvir 400mg	tablet	gastro-hepatologji/ HepatiC
Vemurafenib 240 mg	tablet	për trajtimin e melanomave metastatike
Ruxolotinib 5mg, 15 mg, 20mg	tablet	onkologji/ kancer i rrallë i gjakut
Acetat Abirateroni 250 mg	tablet	onkologji/ kancer të prostatës
Infliximab 100 mg	pluhur për infuzion	rheumatologji/ artrit të formës së rëndë
Glycopyrronium bromide inhalation powder 50 mcg	caps.për inhal.	në pneumologji/ SPOK
Acarbose 50mg, 100 mg	tablet	endokrinologji (diabet)
Alendronat-Cholecalciferol 70mg+5600IU	tablet	rheumatologji
Lixisenatide 20 mg	pen	endokrinologji (diabet)
Fluvoxamine 100mg	tablet	psikoanaleptikët
Ocreotide Acetate 30 mg/2ml	pluhur për injec.	Grupi Hormoneve Hipotalamike
Lomustine 40 mg	tablet	Në tumoret e kokës dhe në metastaza
Everolimus 10 mg	tablet	onkologji, kanceri i gjirit
Barna të reja (forma dhe formëdoza) të barnave ekzistuese		
Emërtimi Kimik	Forma	Shërbimi ku përdoret
Epoetin Zeta 30000 IU	shiringe	në hematologji
Lercanidipine 20 mg	tablet	terapinë kardiake
Telmisartan 80mg	tablet	terapinë kardiake
Ferric hydroxide sucrose complex 100mg/5ml -5ml	ampul	në hematologji
Cefixime 100mg/5ml X 50ml	flakon	
Glycerol Trinitrate 0.5mg	sublingual.tab	terapinë kardiake
Hydrocortisone 17 butyrate 0.1% 30g	tubet	dermatologji
Peginterferon alfa-2b 50mcg, 80mcg, 100mcg	sol për injec	gastro-hepatologji dhe infektiv
Spirololaceton 50 mg	tablet	terapinë kardiake
Levodopa+ Carbidopa (2g+0.5g)/100ml	gel intestinal	anti-parkinsonik

ÇMIMET

Por si kanë ndryshuar çmimet e barnave? Bari Lercanidipine që përdoret në Kardiologji, nga 24.7 lek (çmimi ref/njësi) u ul këtë vit në 15.8 lek. Bari Imatinib që përdoret për Leuçeminë, nga 1776.2 lek është ulur në 384.4 lek. Bari Capecitabin që përdoret në Onkologji, nga 307.90 lek është ulur në 153.6 lek. Insulina Glargine për diabetikët - nga 1891 është ulur në 1461 lek.

RECETA DY MUJORE

Duke filluar nga dita e sotme nis gjithashtu dhënia e recetave për periudha deri në 2-mujore për pacientët kronikë të stabilizuar. Kjo do të thotë se pacientët, sidomos pensionistët (që janë dhe përfituesit kryesorë), do të kenë një lehtësim të ndjeshëm, pasi nuk do ta kenë të nevojshme paraqitjen pranë mjekut të familjes çdo muaj për barnat që marrin rregullisht me rimbursim, por një herë në dy muaj. Përveç rasteve kur ka ndryshim terapie (gje e cila përcaktohet nga mjeku). "Vetëm gjatë një viti, në kemi rimbursuar afro 4.6 milion receta dhe vetëm gjatë vitit të fundit, numri i tyre është rritur me 375 mijë krahasuar me vitin e kaluar", - thekëson Fondi i Sigurimeve. Ky vendim, shkurtor ndjeshëm edhe kohën administrative të mjekut, i cili do të ketë më tepër mundësi edhe për kontrollin mjekësor bazë që ka filluar të ofrohet në qendrat shëndetësore me financim nga FSDKSH.



Prej janarit Instituti i Shëndetit Publik është duke ofruar shërbimin e mamografive të lëvizshme për qendrat e banimit ku nuk ka mamografi. Sipas të dhënave të ISHP-s, nga 15 janari deri tani janë kryer mbi 1000 ekzaminime. "Shërbimi ofrohet falas nga Instituti i shëndetit publik në bashkëpunim me Drejtoritë rajonale të Shëndetit Publik. Ekzaminimin mund ta kryejnë gratë e interesuara në moshën mbi 50 vjeç ose ato të moshës 40-50 vjeç që konsiderohen me risk më të lartë. Me risk të lartë do të konsiderohen ato gra që janë bartëse të defekteve gjenetike, që kanë histori familjare apo personale, probleme beninje të gjirit, në rastet kur është vërejtur fillimi i hershëm dhe mbarimi i vonshëm i menstruacioneve, moslindje ose lindja e fëmijës mbi 30 vjeç, obezitet, ind i ngjeshur të gjirit dhe ekspozim ndaj rrezatimit terapeutik. Orari i shërbimit është 8:00-14:00 nga e hëna deri të premte. Në raste të veçanta, për arsye logjistike transporti, të hënën shërbimi mund të ofrohet pasditë", - përmend në një njoftim Instituti i Shëndetit Publik. Të gjitha gratë e interesuara



Mamografia, ku do kryhen ekzaminimet gjatë muajit prill

10 në 1000 gra të ekzaminuara përfundon në një diagnozë tumori

të grup-moshave të përmendura më sipër duhet të kontaktojnë Drejtorinë e Shëndetit Publik të rrethit përkatës dhe të regjistrojnë emrin në listë. Ato do të kontaktohen nga personeli shëndetësor për ditën dhe orën e ekzaminimit sipas radhës. Mesatarisht çdo ditë njësitë e mamografive kryejnë rreth 15 ekzaminime. Gjithashtu Instituti i Shëndetit Publik thekson se mamografia nuk vendos diagnozën. "Ekzaminimet shtesë, përfshi ekografinë apo edhe biopsinë, do të

jenë të nevojshme për një pjesë të grave. Vetëm më pak se 1% e grave të ekzaminuara mund të ketë tumor malinj. Inkurajohen të gjitha gratë që të kryejnë çdo vit ekzaminimin klinik të gjirit nga një mjek pranë një qendre shëndetësore", - thotë ISHP. Nga të dhënat e disa analizave paraprake, bazuar në gjetjet e fushatën së ndërjegjësimi tor-nornt 2014, vlerësohet se më shumë se 10 në 1000 gra të ekzaminuara përfundon në një diagnozë tumori të gjirit.

Ekzaminimet

- 1-10 prill, Kukës
- 30 mars-3 prill, Biliisht
- 6-17 Prill, Pogradec
- 13-24 prill, Bajram Curri
- 20 prill, Librazhd
- 27 prill, Has



Rama dhe Veliaj në një biznes në Lezhë

Veliaj: Sot miratohet Kodi i ri i Punës për punonjësit Rama e Veliaj: Në 2015-n përfitojnë 7 mijë të papunë

— Gjatë një vizite në një biznes në Lezhë që ka përfituar nga fondi i Nxitjes së Punësimit Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Mirëqenies Sociale Erion Veliaj përmendën se për 2015-n, nga ky fond përfitojnë 7 mijë të papunë. "Fondi i Nxitjes së Punësimit u trefishua, ndërsa për vitin aktual u dyfishua. Në vitin e parë numri i të punësuarve vetëm nga ky projekt të ishte afro

4 mijë persona, ndërkohë që për vitin aktual ky numër pritet të shkojë në afro 7 mijë të punësuar të tjerë", - tha Kryeministri Edi Rama. Ministri Veliaj vuri në dukje faktin se qeveria i ka kushtuar një vëmendje të veçantë mbështetjes së biznesit dhe sipërmarrjes, si promotor të rritjes ekonomike dhe punësimeve në vend dhe bëri të ditur se sot do të miratohet Kodi

i ri i Punës në qeveri. "Kodi i ri i Punës mbrohet me shumë punëtorët. Në fakt, është një nga kodet më moderne. Gratë që vijnë nga leja e lindjes u garanton dy orë pushim në ditë, për sa kohë janë ende duke ushqyer dhe mbajtur një fëmijë. Kurse, për ata që punojnë në turnet e treta, garanton një pagë të veçantë shtesë", - përmendi ministri i Mirëqenies Sociale.

ISHP

Lezhë, përhapet një virus i ri, prek sistemin nervor



Silva Bino

■ Një virus i ri po përhapet në vendin tonë dhe konkretisht në zonën e Lezhës. Virusi i quajtur "Adria", po qarkullon prej 1 muaji dhe Instituti i Shëndetit Publik e ka gjetur fillimisht te disa lloje insektesh. Sipas specialistëve të ISHP-s, nga insektet virusi kaion te njerëzit dhe kryesisht prek sistemin nervor. "Virusi që kemi zbuluar ne quhet "Adria", i zbuluar në flebotomë në Lezhë nga një ekip i përbashkët shqiptarogrek. Deri tani nuk janë vërejtur sëmundje te njerëzit të shkaktuara nga ky virus, kemi përforcuar këtu mbikëqyrje në këto rrethe dhe nëse do të kemi raste të tilla, qoftë me temperaturë, pika të kuqe të lekurë apo infeksione të sistemit nervor qendror, natyrisht duhet të ndërhyjmë menjëherë", - thotë Silva Bino, specialiste e Institutit të Shëndetit Publik. Gjithashtu ISHP thekson se virusi mund të përhapet edhe në zona të tjera për shkak të lëvizjes së insekteve dhe se specialistët po kryejnë kontrole në të gjitha zonat rreth Lezhës. "Nuk është zbuluar te njerëzit, por te flebotomët, që janë një lloj vektor që transmetojnë disa sëmundje virale, apo ethe si ato të Toskanës, Napoli, të cilat shfaqen me temperaturë, me pika të kuqe në lekurë dhe ndonjëherë edhe me prekje të sistemit nervor qendror", - thotë Bino. Kjo nuk është hera e parë që ISHP kryen kontrole në zona të vendit për virus të cilat shfaqen në periudha të ndryshme. Instituti i Shëndetit Publik u bën thirrje qytetarëve që kur vërejnë shenjat e virusit duhet të shkojnë pranë qendrave shëndetësore. Më herët zona të caktuara në vendin tonë, janë prekur kryesisht nga virusi i gripit. Ky është rasti i parë për 2015-n që dyshohet për një virus të ri.

Kualifikimi i mësuesve në prill, si do hartohen testet

Mësuesit do të japin provimin e kualifikimit deri në 3 herë

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË

Në 18 prill do të zhvillohet provimi i kualifikimit të mësuesve dhe do të jetë Instituti i Zhvillimit të Arsimit, i cili do të administrojë testimin dhe llojet e testeve që do të hartohen nga specialistët e IZHA-s. "Mësuesit i nënshtrohen provimit me test të hartuar nga grupe specialistësh sipas profileve përkatëse të ngritura nga IZHA. Testi përban dy pjesë kryesore. Pjesa e parë përban pyetje nga fusha e dokumentacionit shkollor, nga fusha e programit lëndor, aspekte metodike-pedagogjike aspekte të komunikimit - etikës dhe aspekte të fushës së drejtshkrim-it. Pjesa e dytë përban pyetje nga përmbajtja shkencore e lëndës. Gjithsej zhvillohen 43 teste të ndryshme të bazuara në profilet e mësuesve sipas cikleve të arsimit parauniversitar", - përcakton udhëzimi i IZHA-s. Sipas Institutit të Zhvillimit të Arsimit hartuesit e testeve duhet të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë për lëndën përkatëse, ë kenë një eksperiencë pune jo më pak se pesë vjeçare në mësimdhënie dhe të kenë hartuar teste në nivele të ndryshme institucionale. Gjithashtu duhet të kenë rezultate të larta në punën e tyre mësimdhënëse, të kenë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme për zhvillim profesional dhe të japin ose të kenë dhënë mësim në njërin nga nivelet e arsimit parauniversitar (ose Universitar). Duke filluar nga viti 2014-2015 e në vazhdim, mësuesit kanë të drejtë të aplikojnë për të fituar kategorinë e kualifikimit, nëse kanë kryer të paktën 3 ditë trajnim në një vit kalendarik, të cilat janë të barasvlershme me 18 orë trajnim të pasqyruara me 6 kredite. "Komisioni i shqyrtimit të testeve, i ngritur nga drejtori i IZHA-s, identifikon testet e dyshuara për kopjim dhe ankesat e kandidatëve për vlerësimin e tyre. Komisioni përbëhet nga dy vetë, një specialist i kurrikulës i IZHA-s dhe një mësues i lëndës që testohet", - përcakton udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, për provimin kualifikimit të mësuesve. Mësuesit kanë të drejtë të hynë në provim kualifikimi jo më shumë se 3 herë.



Provimi

Udhëzimi

Vlerësimi përfundimtar i kandidatit bëhet me sistemin e 100 pikëve, i cili përbëhet nga pikët e portofolit, bonuseve, të pjesës së parë dhe të pjesës së dytë.

Kriteret

Hartuesit duhet të kenë rezultate të larta në punën e tyre mësimdhënëse, të kenë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme për zhvillim profesional dhe të japin ose të kenë dhënë mësim

Çfarë parashikon udhëzimi

Testet që do të hartohen për kualifikimin e mësuesve

— Instituti i Zhvillimit të Arsimit do të hartojë testin e arsimit parashkollor dhe testin e arsimit fillor. "Testi i arsimit të mesëm të ulët do të hartohen i veçantë për lëndët: Gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, edukim

fizik, muzikë, art pamor, si dhe lëndë të tjera specifike brenda planit arsimor. Gjithashtu IZHA dot hartojë edhe testin e gjimnazit dhe kulturës së përgjithshme të shkollave profesionale, të onentuara dhe speciale për lëndët: Gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, frëngjisht,

gjermanisht, italisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi, qytetari, sociologji, psikologji, filozofi, edukim fizik si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor", - thuhet në udhëzimin e IZHA-s.



Në zgjedhje pa ofruar zgjidhje?

NGA **AFRIM KRASNIQI**

vijon nga faqja 1

Pjesa më e rëndësishme e procesit, sipas vetë partive, është përzgjedhja e individëve, sidomos përcaktimi i koalicioneve dhe aleancave politike. Pjesa tjetër, ajo e integritetit të emrit dhe konkurrimit të cilësive për të arritur tek emir, dhe sidomos, oferta elektorale programore e kandidatit, janë dhe mbeten dytësore, jashtë vëmendjes së partive dhe axhendës së tyre prioritare politike. Qoftë edhe ky tregues i nivelit dramatik të demokracisë përfaqësuese në Shqipëri, i bën zgjedhjet lokale të qershorit një praktikë rutinë, pa pritsmëri të mëdha.

Ka një aspekt të dytë që palët politike dhe kandidatët pretendues për kryetarë të 61 bashkive nuk e citojnë dhe as i japin vëmendje, por që prek thelbin e qeverisjes qytetare në katër vitet e ardhshme. Për shkak të ndarjes së re territoriale drejtuesit e rinj vendorë do kenë territor dhe përgjegjësi të reja nën administrim, pritsmëri dhe detyrime të tjera, numër më të madh qytetarësh votues dhe pretendues për të përfutur nga shërbimet lokale, por edhe sipërfaqe e buxhet të mëdha për administrim. Ndajre është bërë, por e pa shoqëruar me legjislacionin plotësues, - kompetencat dhe ndryshimet strukturore dhe cilësore në raportin midis qeverisjes vendore dhe qendrore. Autoritetet zyrtare dhe partnerët ndërkombëtarë të përfshirë në proces, paralajmërojnë se ligji organik mbi qeverisjen vendore do të jetë gati për miratim politik në fundin e vitit 2016, pra në gjysmën e dytë të mandatit të kryetarëve të rinj të bashkive. E thënë kështu, kryetarët e rinj do të vijojnë të drejtojnë me ligjin e vjetër dhe plotësimet formale që pritet të bëhen këtë muaj, dhe mbeten në pritje të ligjit të ri për të mësuar se cila do jetë hapësira reale e kompetencave dhe përgjegjësisë në administrimin lokal.

Në këto rrethana pyetja më e rëndësishme mbetet: për çfarë do votojnë shqiptarët më 21 qershor? Çfarë do propozojnë kandidatët për kryetarë dhe partitë konkurruese, kur asnjëra palë nuk është në dijeni të plotë mbi kompetencat e pushtetit vendor, që pritet të hyjnë në fuqi në vitin 2017? Si do të paraqiten programe, platforma dhe premtime për dicka që nuk ekzistojnë, që nuk ka mbështetje logjike politike dhe

as financiare dhe që është e mbetet subjektive derisa të miratohet ligji organik? Çfarë premtimesh mund të bëjë një kryebashkiak për arsimin, shëndetësinë, kulturën, legalizimet, pronat, rendin dhe qetësinë, sistemin e taksave për bizneset e mëdha, planet rregulluese, etj, kur këto kompetenca vijojnë të jenë monopol i qeverisjes qendrore dhe që deri në daljen e ligjit të ri, ende nuk janë përgjegjësi e kryetarëve të rinj të bashkisë? Si mund të llogaritet efikasiteti i punës dhe mbajtjes së premtimeve kur asnjë kandidat nuk është në dijeni mbi mjetet monetare në dispozicion në bashki, të drejtat e bashkisë, madje as të kufijve administrativë të bashkisë dhe borxhet ose detyrimet që ajo trashëgon pas llogaritjeve të ndarjes së re administrative? A mundet bashkia të jetë zëri qytetar kur ende nuk ligjërohet e drejta e saj monopol për vendimmarrje në problematikat thelbësore të qytetit dhe jetës në të, nuk ka specifikime të kompetencave të kryetarit dhe këshillit, dhe as rishikim të raporteve të tyre me organet e zgjedhura, sic është prefektura apo sistemi paralel me burim ministrë

e linjës? Shembulli i Vlorës, psh, kur bashkia vendos ndryshe dhe një pushtet i pavotuar jashtë saj anulon vendimin, nuk është vetëm çështje administrative, është çështje që ka të bëjë me thelbin e konceptit mbi



qeverisjen vendore. A do jetë ajo autoriteti kryesor në problematikat lokale? A mund të ketë autoritet tjetër konkurruese, në kushtet kur vetëm kryetari i bashkisë zgjidhet direkt nga qytetarët? Kush ka më

shumë të drejtë morale të flaës në emër të qytetarëve sesa ata zyrtarë që votohen dhe votbesohen prej tyre?

Dhënia e përgjigje mbi këto pyetje u jep përgjigje modelit të qeverisjes lokale aktuale dhe në dekadën e ardhshme. Politika aktualisht nuk ka përgjigje për asnjërin prej tyre, as partitë, as kandidatët, as qeveria dhe as rrjetet e grupeve të interesit që vepron në këtë fushë. Sepse një demokraci e brishtë nga një demokraci funksionale dallohet pikërisht në sistemin e vlerave, prioriteteve dhe përfqësimit që mbart dhe krijon. Modeli ynë merret me emrat, ka prioritet vetëm fitoren elektorale dhe refuzon përfaqësimin direct, kurse modeli i demokracisë funksionale diskuton më shumë

për parimet, programet, kompetencat, reformat e mëdha sesa për emrat, aleatët, pazaret dhe interes nepotike të oligarkisë që drejton prej vitesh partitë kryesore. Parë në këtë këndvështrim dhe nëse askush nuk u jep përgjigje pyetjeve të mësipërme, 21 qershorit nuk ka vlerë tjetër përvece votimin rutinë për të zëvendësuar ca zyrtarë lokalë me ca të tjerë të të njëjtës palë politike ose të palës tjetër. Dicka tërësisht e pamjaftueshme, pa sens, pa ndikim në rritjen e demokracisë dhe krejt e kundërt me pritsmërinë publike dhe detyrimin institucional pas procesit të reformës së re territoriale. Dicka që mendjet e arsyeshme nuk e pranojnë, por që në një shoqëri të dominuar nga propaganda, padjia, militantizmi, etja e pushtetit dhe kultet e liderëve politikë, - nuk ka vlerë tjetër përvece asaj statistikore. Teza profesionale dhe universal se demokracia është shumë më tepër sesa procedurë dhe statistikë, është përmbajtje, transparencë, konkurrencë dhe sistem vlerash, - mbetet e huaj për Tiranën politike ku në vend të ideve e projekteve të mëdha flitet vetëm për emra dhe fasada pas tyre.

Paratë e krimit

NGA **FATOS ÇOÇOLI**

vijon nga faqja 1

...më të larta ku ai ka mundur të depërtojë për të ndikuar, në majat e politikës, rrënjët e tij të paprekura janë në fondet që e mbajnë në aktivitet të plotë. Këto fonde janë para të ardhura nga trafiqet e drogës apo prostitucionit, që kanë fituar "qytetarinë" në ekonominë shqiptare duke u pastruar në dyqane, bare, pika bastesh sportive, restorante, apartamente, pallate të tëra të ndërtuara, motele e hotele. Krimi ka paguar tatimorë e doganierë, nëpunës arkivash e hipotekash, të gjendjes civile, etj, duke fituar "letra të pastra" për kapitalet që ka investuar. Ka madje edhe filiale bankash që kanë rënë në këtë rrjetë të stërholluar të përgatitur me shumë kujdes nga mafiozët shqiptarë. Deri tani shoqëria shqiptare ka reaguar pak ose asfare për lidhjet e krimit dhe përhapjen e tij të gjerë në jetën

e vendit dhe në ekonomi. Është mjaftuar me akuzat e kundër-akuzat e politikanëve të dy formacioneve kryesore kundërshtarë, edhe pse këto veprime kanë patur shumë pak baza të vlefshme për t'u marrë parasysh nga një organ profesional i akuzës. Kanë munguar denoncimet e qytetarëve kurajoze, aq të përhapura në vendet perëndimore që duam t'u ngjajmë, ku vetë qytetari mbrohet dhe zbulon, me ndihmën e policisë dhe prokurorëve të aftë e të ndershëm, kriminelin e lagjes apo të bllokut ku banon. Krimi tek ne, edhe pse po goditet në nivelin ku ai ndikon në politikën e vendit, e ka të paprekur fuqinë, pse nuk i janë dëmtuar fondet që ka tjetruar nga fitimet e paligjshme. Në momentin kur ish-Kryeministri kroat u arrestua për marrje rryshfetesh nga kompani dhe një bankë e huaj, atij ju sekuestruan dhe ju bllokuan të gjitha llogaritë bankare. Këtu tek ne, në rast se duam që krimin ta kufizojmë në skutat nga ka filluar, duhet të hetojmë me qetësi e metodikë çdo gjurmë të parave të butikëve, dyqaneve, restoranteve, kafeneve, apo edhe kompanive që rrinë kot në qendër të qyteteve tona, pa xhiro, pa këmbë klienti, dhe që mbahen vetëm nga fonde shumë të dyshimta. Këtë mund ta bëjë vetëm një strukturë e specializuar dhe strukturat e Krimit Ekonomik brëndë Policisë apo Prokurorisë sonë janë të pamjaftueshme. Së pari, nuk mjafton stafi i tyre, i përbërë vetëm nga policë apo hetues karriere, pse kërkohen financiarë, ish-bankierë,



punonjës hipotekash, etj., të aftë të zbulojnë tentakulat ekonomike të krimit. Sikurse e ka cilësuar vetëm gjashtë muaj më parë Kryeprokurori britanik Oliver Heald: "Krimi është gjithnjë një hap përpara nesh. Ai përbën një rrezik real për shoqërinë, demokracinë dhe ekonominë tonë. Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe rregullatorët kërkojnë t'i bëjnë ballë, duke zbatuar ligjet ekzistuese për sjellje kriminale që nuk kanë qenë butikëve, dyqaneve, restoranteve, kafeneve, apo edhe kompanive që rrinë kot në qendër të qyteteve tona. Dhe për ne, këtu në Shqipëri, për strukturat përgjegjëse të Shtetit tonë, kryesorja është të dinë se si vepron krimi me paratë e tij. Ku i investon, ku i fshih, kur i

vë në lëvizje, ku i shumëfishon. Për këtë Policia e sidomos Prokuroria, kanë nevojë për informacionet nga Hipotekat, për informacionet të detajuara nga drejtoritë e tatimeve dhe doganave, për hetime të thelluara e kapilare për kompani të dyshimta, apo hotele, motele, dyqane e pika lloshor, pronarë e të cilave kanë mbirë pa asnjë lloj aktiviteti apo gjurmë biznesi në të kaluarën. Sigurisht që në këta pronarë pa gjurmë të mëparshme biznesi e investimesh, ka edhe njerëz normalë që kanë trashëguar një pasuri apo fituar para e prona në formë dhurimesh. Por këta janë të paktë. Më të shumtë ose janë vetë mafiozët e drogës dhe prostitucionit, të konvertuar në sipërmarrës, ose farefis e miq të tyre, që menaxhojnë për llogari të tyre paratë e krimit. Pa këtë zbirim e hetim në nivel kombëtar e të plotë, nuk do të jemi në gjendje kurrë ta godasim fort dhe në zemër krimin ekonomik shqiptar.



Big Brother 8

Nevila e Valeri mbyllin misionin


Vendimi i Vëllait të Madh krijon konfuzion tek banorët

Nga java në javë, shtëpia e cila nuk fle kurrë, ajo e "Big Brother", është vizituar nga dy mysafirë, siç edhe është njoftuar nga Vëllai i Madh. Nevila dhe Valeri, ishin të ftuarit special, të cilët kryen misionin e liderave të shtëpisë dhe deleguan disa vendime të rëndësishme. Ndërkohë, banorët e "Big Brother" shijuan ndeshjen e famshme Shqipëri-Armeni, brenda ambienteve të shtëpisë më të famshme në Shqipëri edhe pse me vonesë. Të gjithë ishin shumë të entuziasmuar dhe shijuan fitoren e kombëtares. Ky "happy hour" u organizua nga ish-banorët finalistë të edicionit të mëparshëm. Gjatë këtyre

orëve gazmore u dhanë dhe vendime të rëndësishme! Banorët do të luajnë tek duke ndarë çiftet, por kjo nuk mirëprit dhe aq mirë, madje krijoj konfuzion tek disa prej tyre. Pas këtij vendimi, Marina flet menjëherë me Eleonorën se si do vazhdojë, sepse ajo nuk di të bëjë lojë. Eleonora e këshillon që ajo të jetë vetvetja. Eleonora i thotë Marinës që do ta ketë gjithmonë në zemër. Xhensila ndryshe nga Marina është shumë e lumtur. Xhensila thotë se ajo me Zaidën janë shumë të kundërta në mendime dhe tani do të jetë e lirë t'i kundërvihet kur ka diçka që nuk i pëlqen. Lideri i shtëpisë u vendos Diedoni, i cili u mirprit edhe nga banorët.

Festivali

"Im Live" e Elhaida Danit vazhdon të ngjis shkallët



— Një sondazh i krijuar nga Eëiblogs ka renditur Elhaida Danin si këngëtares e dytë më të pëlqyer në Eurovizion. Kënga e Danit "I'm Alive" ka fituar 9 përqind të votave duke u renditur e dyta. Kuptohet këto sondazhe nuk kanë ndonjë peshë të madhe, por gjithsesi janë tregues i mirë për festivalin European të Këngës.

Mister Kosova:

Kika ka kërkuar seks me mua në këmbim të parave

— Sapo ka lënë shtëpinë e Big Brother, Kika është përballur me të tjera akuzat jashtë shtëpisë. I ftuar në emisionin "Fan Club" në Top Channel, lojtari nga Kosova u përball me akuzat që edhe një herë tjetër vinin në diskutim seksualitetin e tij. Kika është gjendur përballë një situatë shumë të sikletshme, ndërsa Mister Kosova, Kastriot Muçiçi, e ka akuzuar atë live në një linjë telefonike për ngacim seksual. Muçiçi ka treguar në emisionin e moderuar nga Albana Osmani se nuk është paguar nga Kika edhe pse ka marrë pjesë dy herë në spektaklin e organizuar nga ai, madje ky i fundit i ka kërkuar seks në këmbim të parave. I eleminuari i shtëpisë së Big Brother e ka mohuar deklaratën e Mister Kosovës dhe është shprehur se ishte vetë ai që e kishte ngacmuar seksualisht. Të mos harrojmë që ish-bashkëshortja e Kikës, rrëfeu në një intervistë arsyen pse u divorcua nga Kika dhe kjo arsye ishte pikërisht homoseksualiteti i ish-burrit të saj.



Kalendari Kulturor

TEATRI KOMBËTAR EKSPERIMENTAL "KUJTIM SPAHIVOGLI"

■ *Premiera e re duke filluar nga 4 Prill ora 20:00 në TKE "Spahivogli" vepra e famshme e Bertolt Brecht, "Arturo Ui".*

Përktheu : Robert Shvarc

Regjia : Kiço Londo

Skenografia : Kristo Çala

Kostumografe : Sofi Kara

Me aktorët : Denis Kurushi, Fatjon Mici, Rezart Barjoti, Ergys Çekrezi, Erjon Hinaj, Amir Hasanlliu, Elidon Alike, Dervish Biba, Erlin Visha, Roland Saro, Redian Mulla, Ina Morinaj, Oriana Cama, Xhuliano Briskaj, Endri Çela, Donald Shehu, Arjola Basho, Sara Jaupaj, Ilirida Bejleri, Kristiana Dodaj, Endri Hekurani



PROGRAMI I FILMAVE NE RRJETIN IMPERIAL PER DT 26.03.2015 - 01.04.2015

SALLA 1

- "The Gunman" 2D / 20:30 / Çmimi 500 Leke
- "Divergent Series Insurgent" 3D / 15:30 / Çmimi 500 Leke
- "Die Mannschaft" 2D / 22:30 / Çmimi 500 Leke
- "Cinderella" 2D / 13:00 / 18:00 / Çmimi 500 Leke
- "Spongebob" 3D / 10:30 / Çmimi 400 Leke

SALLA 2

- "Still Alice" 2D / 21:00 / Çmimi 400 Leke
- "Home" 3D / 13:00 / Çmimi 400 Leke
- "The Gunman" 2D / 19:00 / Çmimi 500 Leke
- "Divergent Series Insurgent" 3D / 17:00 / Çmimi 500 Leke
- "Cinderella" 2D / 11:00 / 15:00 / Çmimi 500 Leke

KINEMA AGIMI

- "Home" 3D / 10:00 / Çmimi 400 Leke
- "The Gunman" 2D / 20:00 / 22:10 / Çmimi 500 Leke
- "Divergent Series Insurgent" 3D / 12:30 / 17:30 / Çmimi 500 Leke
- "Cinderella" 2D / 15:00 / Çmimi 500 Leke
- **Premiere Dt 02.04.2015**
- 1- "Fast & Furious 7" 2D

» INTERVISTA

I NDALUR që në vitet '50 në Shqipëri, ky mjeshtër i letërsisë klasike botërore lexohej fshehtas. Përkthyesi i 12 veprave të Dostojevskit rrëfen sesi e sollë në shqip vetëm pas viteve '90. Në intervistë trajtohen edhe problemet e sotme të përkthimit

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Një nga përkthyesit më të mirë të letërsisë botërore, Jorgji Dhoksani, i nderuar së fundmi edhe me Medaljen e Artë "Lermontov" nga Rusia si përkthyes i Dostojevskit në shqip, rrëfen arsyet e censurimit që iu bë shkrimtarit të madh rus me famë botërore në Shqipëri. Paradoxikisht Rusia, vendlindja e Fjodor Dostojevskit, edhe pse shkrimtari nuk përfaqëson asnjë ideologji komuniste, nuk e ndaloi kurrë veprën e tij. Në Shqipëri u ndalua. Por, a ndalën shqipëtarët së lexuari Dostojevskinin, si u njohën ata me shkrimtarin e madh para dhe pas viteve '90. Kush është Dostojevski dhe cilat janë të panjohurat që na rrëfen për jetën e tij përkthyesi Jorgji Dhoksani. Jorgji Dhoksani është nderuar në fillim të marsit të këtij viti edhe me titullin "Mjeshtër i madh" nga presidenti i Republikës.

Përkthyesi i 12 vepave të Dostojevskit nga gjuha ruse në gjuhën shqipe rrëfen se historia e botimit të tij në gjuhën shqipe është një tregues i atyre ndryshimeve të mëdha kohore që ndodhën në Shqipëri pas çlirimit të vendit dhe sidomos mbas një kthese të mprehtë dhe të rëndësishme që mori politika e vendit pas viteve gjashtëdhjetë e sidomos pas viteve '70 e këtej, që kulmoi në ndalimin arbitrar të tij në programet universitare dhe zhdukjen e origjinalit nga bibliotekat tona. Pas viteve '70 Dostojevski as nuk duhej të zihet në gojë. Kjo ishte periudha që Shqipëria u prish edhe me kampin socialist e me perëndimin nuk kishte asnjë marrëdhënie. Ideologjia e vetme që preferohej të buronte nga letërsia ishte "të ecim përpara në gjurmët e Marksizëm-Leninizmit" dhe "të zhvillojmë në mënyrë të pandërprerë luftën e klasave". Po a mund ta sillte dot vepra madhështore e Dostojevskit një mesazh të tillë.

Profesor Dhoksani, ju jeni përkthyesi i kolanës me 12 vepra të shkrimtarit të madh rus Dostojevskit. A mund të më kujtoni si dhe pse u censurua Dostojevski në Shqipëri, ndërkohë që nën zë flitej mes intelektualëve për veprën e tij?


-Dostojevski ka një veçori në veprat e tij, që përcjell mesazhin se duhet të heqim dorë nga dhuna, sepse sipas konceptit të Dostojevskit çdo dhunë shkakton zinxhirin e një dhune tjetër. Dhe duhet hequr dorë nga çdo lloj dhune, dhe asgjë nuk rregullohet, nuk përmirësohet me dhunë. Kjo është ideja e nënkuptuar në të gjitha veprat e Dostojevskit, por në fakt, kjo është edhe ideja e hershme e krishtërimit, e Biblës. Dostojevski ka meritën e madhe se pasqyroi artistikisht këtë ide, duke na lënë në historinë e letërsisë figura të mëdha të paarrtshme që mbeten edhe sot një nga realizimet më të mëdha artistike të botës. Kuptohet me këtë "bagazh ideologjik" Dostojevski nuk mund të përkthehej në gjuhën shqipe, dhe udhëheqësi i Partisë në atë kohë, Enver Hoxha, e quajti atë me një përkufizim shumë të shkurtër "është shkrimtar reaksionar". Pas kësaj ai u hoq nga programet e shkollës e të universitetit, botimet e tij nuk u lejuan dhe ky ishte fati i veprës së tij, derisa erdhën vitet '90 që shqipëtarët të mund të kishin në dorë Dostojevskinin të përkthyer në gjuhën e tyre.

Megjithatë Dostojevski kishte hyrë në Shqipëri. Njihej në rininë tuaj, aty nga vitet '60, i lexuar edhe në origjinal, apo jo. Çfarë ishte ky shkrimtar për ju dhe brezin tuaj. Ç'vend zinte në kulturën tuaj letrare?

-Unë kam një biografi specifike, sepse unë kam studiuar jashtë shtetit. Kam studiuar në Rusi dhe atje ishte në programet universitare. Në Rusi Dostojevski nuk ka qenë i ndaluar asnjëherë. Por unë nuk do flas për veten time se çfarë studiova atje. Unë do të flas për rininë shqiptare që ishte këtu, si e njihje ajo shkrimtarin e madh. I vetmi libër i Dostojevskit që u përktheu aty nga vitet '53 është "Njerëz të varfër", një libër i vogël i tij. Dhe pas kësaj asnjë gjë nuk pati në gjuhën shqipe, nuk u botua më asgjë. Ndërsa në Kosovë ka qenë botuar. Në Prishtinë janë botuar edhe "Idioti" i Dostojevskit edhe "Krimi e ndëshkimi". Janë botuar në dialektin e tyre, kuptohet, por për hir të së vërtetës kosovarët nuk i bënë aq mirë ato përkthime, nuk ishin me nivel të lartë, por megjithatë ndonjëri i interesuar i mori ato vepra dhe i sollë në Shqipëri. Sidoqoftë ishin në shqip. Të mos harrojmë që Dostojevski



Jorgji Dhoksani



Fjodor Dostoevski

Jorgji Dhoksani:

Si u censurua Dostojevski në Shqipëri

Të panjohurat për shkrimtarin me famë botërore.

E. Hoxha e quajti shkrimtar reaksionar.

Etja e lexuesit shqiptar për veprën e tij




Spitali ku lindi dhe jetoi Dostoevski në Moskë

ishite përkthyer në gjuhët e huaja. Në Itali, ai ishte autori më i lexuar. Libraritë dhe bibliotekat e Italisë ishin plot e përplot me romanet e Dostojevskit. Natyrisht edhe në frëngjisht, edhe në gjermanisht, anglisht, etj, ai ishte një nga autorët më të lexuar. Edhe në Shqipëri lexohej, por në rusisht, sepse në atë kohë e dinin shumë vetë këtë gjuhë. Në rusisht Dostojevski ka qenë futur në Shqipëri deri në vitet '60. Dhe mos harro se në atë kohë tek ne kishte shumë intelektualë që dinin rusisht, por ai i botuar në gjuhën shqipe nuk ka qenë.

Kur nisi të përkthehej në gjuhën shqipe?

Vetëm pas viteve '90 filloi botimi i Dostojevskit në gjuhën shqipe. Dhe unë isha i lirë vetëm pas viteve '90 ta përktheja. Kështu që nisa t'i përkushtohesha tërësisht Dostojevskit. Të them të drejtën, ideja e kësaj mungese më erdhi edhe për arsye ekonomike, sepse isha shumë ngushtë dhe iu përvesha pu-



Censura

Unë do të flas për rininë shqiptare që ishte këtu, si e njihje ajo shkrimtarin e madh. I vetmi libër Dostojevskit që u përkthye aty nga vitet '53 është "Njerëz të varfër", një libër i vogël i tij. Dhe pas kësaj asnjë gjë nuk pati në gjuhën shqipe, nuk u botua më asgjë. Ndërsa në Kosovë ka qenë botuar. Në Prishtinë janë botuar edhe "Idioti" i Dostojevskit edhe "Krimi e ndëshkimi".

nës që të përktheja. Me shtëpinë botuese me Xhevahir Lleshin ne bëmë planin ta përkthenim Dostojevskin të plotë. E nisëm me kryeveprat. "Krimi e ndëshkimi" e botuam që në film. Ka një kujtim vet Dostojevski nga "Shtëpia e të vdekurve", të cilin e botuam më vonë. Pastaj vijuam me "Idiotin", pak më vonë nga viti '95-'96 me veprat e tjera. Fillimisht i kemi botuar veprat e tij me letër të keqe. Nuk kishte më letër gazete. I kemi botuar me ato letra që kishin mbetur që nga koha e monizmit në depo. Me ato janë botuar pas viteve '90 edhe autorë të tjerë të ndaluar si Kafka, Kamyja, etj. Por ç'ndodhi. Rinia shqiptare me shumicë shumë të madhe doli jashtë shtetit, pati emigrantë dhe ata kudo që ishin kërkonin libra në gjuhën shqipe. Kur shoh unë, për çudi emigrantët në Greqi kërkonin të blenin Dostojevskin, edhe ata në Gjermani e gjetkë prapë kërkonin Dostojevskin. Nuk ishte parashikuar kurrë se librat e Dostojevskit do të blihehin nga emigrantët shqiptarë. Me sa duket se ishte një autor që iu kishte munguar, që kishin dëgjuar për të, ose që u kishin treguar ata që e lexonin në gjuhë të huaja. Kjo ishte e paparashikueshme. Ngaqë emigrantët nuk i zotëronin shumë mirë gjuhën e vendeve përkatëse, vepra e Dostojevskit pati shitje kolosale. Botuesi zuri pasuri dhe duke qenë njeri me kulturë, që unë e vlerësoj këtë, më tha se do nisim botimin me vëllime të plota dhe unë i pashë edhe njëherë nga e para. Ai më krijoi kushtet e redaktimit dhe përkthimit. Erdhi dita dhe ne botuam edhe vëllimin e fundit fundit "Vëllëzërit Karamozov" aty nga viti 2014. Mbaroi kjo gjë dhe botuesi tha që ta botojmë kolanën me 12 vëllime me lidhje speciale dhe ky mbeti formati më i mirë me letra cilësore, gërmë të kthjellët. Jo për mburje, por është botimi më i mirë.

Si nisi konkretisht ndalimi i Dostojevskit. Si e kujton ti?

-Nga ideologjia u nis ndalimi. Sepse si në Bibël që thuhet që në qoftë se njeri të bie nga njëra faqe, ti shtrij faqen tjetër", edhe Dostojevski të lë të kuptosh se nëse dikush të bën një të keqe ti mos ia kthej me të keqe, por përkundrazi, ktheja me të mirë. Dostojevski është shkrimtari më i madh në botë që ka shkruar kundër terrorizmit. Nëse je i dhunshëm, sipas Dostojevskit, ti s'mund të jesh njeri me të ardhme të mirë,



ti vetvetiu e ke dënuar veten.

Nuk e arriti brezi ynë momentin kur ai u ndalua, sepse realisht ai u ndalua të përkthej në shqip që në vitet '50, sepse Dostojevski ishte antimarksisht. Dostojevski nuk i pranonte revolucionet si rrugën e zhvillimit, sepse pranonte evolucionet, ndryshimet dhe sipas Dostojevskit ndryshimet nuk mund të vijnë nëpërmjet dhunës, por nga evolucionet, nga ndryshimet. Dhe e mira sjell të mirën.

Kështu i ka konceptet, i ka në gjak këto ide dhe i ka realizuar artistikisht në mënyrë gjeniale.

Çfarë origjine kishte, cila ishte prejardhja shoqërore e Dostojevskit?

-Dostojevski ishte aristokrat rus nga prejardhja, por i ati i tij ra nga vakti, aq keq ishte ai. Dostojevski ka qenë fisnik rus, por aq keq ka ngelur ai, sa thonë se ka lindur në një spital, sepse edhe shtëpi nuk kishte. Aty bënë një dhomë të spitalit si shtëpi dhe aty ka ndejtur nëna e tij kur lindi Dostojevski. E ëma e Dostojevskit ishte oborrtares dhe ishte njeri me kulturë. Të gjitha kujtimet e mira Dostojevski i ka për të ëmën. Prindërit e tij vdiqën herët dhe ngeli vetëm me vëllanë. Kjo është me dy fjalë biografia e tij. Por ajo që duhet thënë është se çfarë ndodhi kur ishte në Petërburg. Ai mëson se ca të rinj mblihdeshin në mënyrë fshehtë dhe flasin gjëra të ndaluara. Ky që ai mendonte ishte grupi i Petrashevskit një revolucionar anarkist. Ishte grupi që planifikonte vrasjen e carit se ata anarki synonin. Ishin për gjakderdhjen dhe mendonin se duke vrarë krerët, mund të hiqej e keqja. Këta po bënin plane për vrasjen e carit. E mëson këtë policia dhe i bastisi. Dostojevski kishte vajtur atje thjesht për të dëgjuar nga kurioziteti. Nuk ishte anëtar i grupit, por e rrethuan dhe e kapën, pa pyetje fare se ç'bënete atje. E dënuan me internim, madje edhe me vdekje. Fati i tij që car, Lartëmadhënia e Tij e mëshiroi dhe dha urdhër që Fjodor Dostojevski të mos vritet si tre anëtarët e grupit, por t'i kthehet nga vrasje në dënim me internim, me burgim në Siberi, në kampet e tmerrshme. "Shtëpia e të vdekurve" e Dostojevskit flet për internimin që ka përjetuar ai. Ky ka qenë fati i Dostojevskit. Ai s'ka qenë i lidhur me dhunën. Në internim ai e kuptoi se çdo të thoshte dhunë e të të marrin shpirtin dhe shkroi për këto ide kundër dhunës. Pastaj u rehabilitua më vonë. Doli nga burgu e vajti ushtar. U martua e jetoi në Petërburg. Jashtë shtetit udhëtoi shumë. U bë shkrimtar me famë. Të mos harrojmë edhe një gjë tjetër, Dostojevski që e dënuan me grupin që do të vriste carin, u bë më vonë mësuesi i fëmijëve të carit. Fëmijëve të carit nuk u jepte mësim një njeri dosido. Ai ishte shkrimtar i madh në atë kohë, me shumë emër. Vepra e tij është edhe pasqyrim i kësaj jete shumë të trazuar dhe të çuditshme.

Tashmë ju jeni një përkthyes që mbani Medaljen e Artë "Lermontov dhe "Mjeshtëri i madh", me respekt do të dëgjonin se çfarë problemesh hasni në përkthimet e sotme?

-Përkthimi sot ka shumë probleme, të rinjtë nxitojnë. Përkthimi është nazeli, do lëminim, duhet shumë vullnet dhe durim në përkthim, duhet të bësh një studim të larmishëm, sepse gjuha është oqean, se duhet para se të përkthesh të lexosh edhe shkrimtarët e tu, përkthyesit e vendit tënd. Tjetra, nuk depërtohet në thellësitë e originalit dhe sidomos shkrimtarët e shekullit të '20 që përdorin abstraksionin japin sinjale dhe jo të gjithë mesazhin. Ka vështirësi këtu. Përkthimi i mirë arritet duke ditur mirë origjinalin, nuk do marrë në sipërfaqe përkthimi. Po t'i biesh për shembull sipërfaqësisht Dostojevskit, ai mbaron si shkrimtar, ai nuk është më. Duhet të hysh në qelizën e jetës së shkrimtarit, të filozofisë së tij, stilit të shkrimtit. Duhet të dish të nxjerrësh sipër brendësinë e shkrimtarit. Kështu do bëhet edhe me Danten. Ne në sipërfaqe mund të themi: ja ky është Ferri kështu e ashtu, histori është: por jo, përkthyesi sjell madhësinë e Dantes si shkrimtar në gjuhën e tij. Prandaj nuk duhet të ngutemi në përkthimet letrare, sepse në gjuhën tënde do të sjellësh shkrimtarin, jo thjesht historinë e librit.

Po vijoni me përkthime të tjera nga rusishtja në shqip?

-Po kam një shkrimtar të dashur, Kuprinin. E ndjej shumë personalisht. Është i ngrohtë. Kam përkthyer romanin e famshëm të tij "Gropa", që është bërë film në Rusi dhe është një nga filmat më të mirë që kanë rusët. Ka një vështrim humanist madhështor. Unë kam përkthyer tregime të zgjedhura të Ivan Kuprinin. Është shitur edhe ky autor. Kam në dorë edhe "Ana Kareninën" për ta përshtatur për shkollën.

"Ana Karenina" e Tolstoit ishte e përkthyer dhe pas viteve '70 u censuroi.

-Po, Tolstoi ka thënë se Ana Karenina jam unë. Është roman i madh ai. Ana mbeti një nga figurat më të adhuruara në letërsinë botërore. Tolstoi ka tri romane të mëdhenjë në shqip: "Lufta dhe paqja", "Historia e Familjes" dhe "Ana Karenina". Tolstoi ra në dorë të përkthyesve të mirë, si Sotir Caci, Vedat Kokona dhe Petro Zheji. Vedat Kokona e ka përkthyer nga frëngjishtja "Ana Kareninën", por më ka thënë se e ka konsultuar me rusishten, se e ka mësuar autodidakt. Edhe unë vet e kam përkthyer "Ana Kareninën" pas Vedat Kokonës nga origjinali në '99-n.

»» MBRESA

Kujtime nga ditët e trishta në internim të socialdemokrates së parë shqiptare...
Si jetonte dhe si u imponohej me praninë e saj banorëve të qytetit të vogël...



Si e njoha MUSINE KOKALARIN në Rrëshen

Për Musine Kokalari kam ndjerë një dhimbje në shpirt, që kur e pashë për herë të parë në Rrëshen. Më erdhi sërisht në kujtesë, kohët e fundit, kur po lexova pjesë nga libri i Eglantina Mandisë "Nusja e Panusëruar", kushtuar figurës së saj. Një kolose si ajo, pati atë fund tragjik nga një regjim monster.

Fytyra e parë që më ka bërë përshtypje në Rrëshen, kur shkova atje me punë si mësuese e anglishtes, në fundin e viteve '70, ishte ajo e kësaj gruaje me pamje fisnike dhe ecje krenare. Shpesh e ndeshja në dyqanin e bukës ose pasditeve kur bënte shëtitje përgjatë rrugës së Urës së Fanit. Vishte një pardesy në ngjyrë gri e të bardhë, me kepuce demodé por të fisme dhe të mbajtura me kujdes, me një çantë, edhe ajo e kohëve të dikurshme dhe ecte me atë hapin e saj të vogël ngadalë. Hidhte një veshtrim ngulitës që mua shpesh më dukej sikur thoshte: "Unë jam ajo". Një nga shoqet që e njihite më thotë: "Kjo është socialdemokratja e parë, është grua shumë inteligjente. Këtu është e internuar." Ato fjalë

sikur më shkundën dhe thashë më vete: "Pse kaq e rrezikshme një grua! Ishte Musine Kokalari. Që prej asaj kohe, Musineja u bë një personazh që mua, nuk e di për çfarë arsye, më tërhiqte gjithmonë vëmendjen.

Më pas mësova shtëpinë ku jetonte Musineja. Ajo ishte në të dalë të Rrëshenit, rrugës për në Tarazh e Kurbnesh. Një shtëpi dykatëshe si e lënë pas dore, në mes të një fushe të vogël, që kur binte shi dukej si shtëpia në ishull. Një njeri i atyre përmasave jetonte në atë mizerjel! Rrësheni ishte qytet shumë i vogël dhe të binte të shikoje të njëjtët njerëz disa herë gjatë ditës. Një ditë bashkë me një shoqen time shkuam në mini-markatën e qytetit. Kishte katër dyqane të vendosura në meqenë simetrike. Dy ishin gjerat që gjëje sa herë shkoje në dyqan: njerëz në pritje të furnizimit dhe kavanoza me fergesë, që ishin aq të lashta sa kishin një pamje të venitur, si vetë jeta në ato kohë. Atë ditë Musineja ishte e vetme në dyqan dhe po rrinte duke pritur furnizimin. Kur ne pamë dyqanin bosh thirrëm njëherazi: "Bobo, nuk paska asgjë këtu!" Dhe ia dhamë një të qeshure, siç mund të qeshin vajzat e reja që nuk e dinin rrezikun e atyre fjalëve! Ajo na nguli sytë të djave, me një buzëqeshje të lehtë. E kam parasysh si tani atë vështrim, disi qortues. M'u duk sikur na mëshiroi e tha me vete – të shkretat vajza!

Një ditë tjetër e pashë Musinën mu para Pallatit të Kultures, ku ishte biblioteka e qytetit, duke mbajtur me zor një tufë veprash



Me veprat e Enverit

Një ditë tjetër e pashë Musinën mu para Pallatit të Kultures, ku ishte biblioteka e qytetit, duke mbajtur me zor një tufë veprash të Enver Hoxhës. Menjëherë m'u kujtuan fjalët e shoqës sime - grua inteligjente - dhe në çast mendova: "Kushedi se ç'thotë kjo me vete për ato vepra..., sepse nën zë njerëzit ku e ku kishin filluar të pëshpërisnin, madje edhe të bënin ndonjë shaka të hidhur me marritë e tij në to, si për shembull kur shkruante për Hysni Kapon: "Sot kisha Besnikun për drekë..."

të Enver Hoxhës. Menjëherë m'u kujtuan fjalët e shoqës sime - grua inteligjente - dhe në çast mendova: "Kushedi se ç'thotë kjo me vete për ato vepra..., sepse nën zë njerëzit ku e ku kishin filluar të pëshpërisnin, madje edhe të bënin ndonjë shaka të hidhur me marritë e tij në to, si për shembull kur shkruante për Hysni Kapon: "Sot kisha Besnikun për drekë..."

Unë jepja mesim në shkollën "Bardhok Biba", në 8-vjeçare. Një prej nxënësve të mi quhej Orest Kalo. Kishte dy sy të mëdhenj në ngjyrë ulliri, dhe dukej sikur do të'i përpinte të gjitha sa thojë në klasë. Femijë i zgjuar dhe me tabiate të mira: i qetë, i sjellshëm, i pastër dhe i rregullt, por çë do, ishte me biografi të keqe. Kjo ishte gjëja e parë që mesoje kur filloje punën si mësuese në Rrëshen. Oresti ishte nxënës në klasën që kishte në kujdestari Jolanda Bajrami. Ulej në rreshtin e fundit nga muri. Një ditë kishte bërë detyrat e anglishtes, por i kishte tejkaluar kërkesat e detyrës. Unë e pyeta "Kush të ka ndihmuar?" Dhe ai m'u përgjigj "Musineja, mësuese" dhe vazhdon të m'i ngulte sytë në pritje të reagimit tim. Në atë çast u turbullova dhe munda të artikuloja vetëm fjalët "shumë mirë".

Pas disa kohësh kur arriti në klasën e tetë, vura re që Oresti filloi të binte nga mësimet dhe një ditë tek po kontrolloja detyrat (stili i vjetër i mësuesve) i thashë: "Orest, ti ke qenë nxënës i mirë, ti tani nuk mëson si më parë". Në këtë kohë, Oresti më drejtohet mua dhe me

thotë: "Mësuese, unë në fermë do punoj, nuk më duhet anglishtja". - Jo, - i thashë unë - si për ta kundërshtuar - se gjuha është një armë e fortë... nuk arrita ta mbaroja fjalinë, dhe shkova në krye të klasës. Ishte një ndër ato gjeurat që thonim shpesh ato kohë. Të dëgjoje fjalë të tilla nga një femi ishte vërtet tronditëse. Femijë i pjekur para kohe. Ndoshta kuptonte edhe më shumë se mësuesja e tij!

Kur mbaroi mësimi shkova në dhomë dhe, me mendjelehtësinë time, ua tregova shoqëve të dhomës. Njëra prej tyre më tha: "E mi se këta janë ato që i kundërvihen pushtetit!!!" Në moment e kuptova që i kisha dhënë gojës shumë, prandaj nuk fola fare. Mirëpo ajo shoqja, kur iu preken interesat nga regjimi komunist ndërroi, na u bë demokrate e madhe kur filluan ndryshimet demokratike në Shqipëri. Ja... kjo është demokracia shqiptare!

ZANA LITA
Toronto, Kanada
(ish-pedagoge e Anglishtes në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Tiranë.)

» » **SPECIALE**


Autori i këtij shkrimi Sabit Abdylly u lind në vitin 1946 në Kabash. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Viti. Studimet i bëri në Shkup e Prishtinë. Shkruan poezi e prozë. Artikujt për migrimet e shqiptarëve në Zelandë të Re janë përmbledhur në librin "Bijtë e shqipës në tokën e reve të bardha". Ka botuar edhe librin dokumentar "Ankthi i Pranverës '99" për ngjarjet gjatë luftës së vitit 1999 në fshatrat e Moravës së Epërme. Po ashtu edhe monografia e parë e shkruar për Kabashin e Anamoravës mban siglën e tij. Në vitet 1991-1999 ka punuar si përgjegjës dhe mësimdhënës në paralelet e gjimnazit "Kuvendi i Lezhës", në Kabash. Sabit Abdylly që nga 29 tetori 1999 jeton dhe vepron në Auckland - Zelandë e Re.

NGA **SABIT ABDYLI**
TIRANE

(Vijon nga dje)

Me punë krijuam kushte të mira për të jetuar. Besoj se edhe para nesh ka pasur shqiptarë në Zelandë të Re. Kur erdhëm takuam një femër shqiptare e ardhur nga Egjipti e cila fliste mirë shqipe n.n. Çka u bë me të më vonë nuk di. Flitej edhe për tri gra shqiptare tjera nga Llogoraja e Vlorës të vendosura këtu para nesh, pastaj për shqiptarët nga Australia, të cilët kishin ardhur për të kërkuar flori në lumenjtë e këtushëm, por ata nuk kanë qëndruar gjatë në Zelandë të Re. Sidoqoftë, ne ishim emigrantët e parë politikë shqiptarë, me numër kaq të madh, të vendosur në këtë lshull të largët. Këtu ne formuam Lidhjen Qytetare të Shqiptarëve në Zelandë të Re. Kryetari i Lidhjes Mazhar Krasniqi dhe të gjithë ne të tjerët i përqendruam forcat në ruajtjen e traditave, gjuhës... mbajtjen e lidhjeve, qëndrimeve në sensibilizimin e çështjes së pazgjidhur të Kosovës me mërgatat simotra shqiptare në Australi, në Amerikë e gjetiu.

Tuboheshim gjatë uikendeve, festave dhe kurrë nuk harruam prej nga kishim ardhur, kurrë nuk i humbëm shpresat se një ditë do ta thyejë qafen diktatura e kuqe. Me rastin e festes së Flamurit takoheshim në shtëpinë e njërit prej nesh dhe festonim familjarisht, para flamurit kuq e zi këndonim himnin, dëgjonim muzikë shqipe evokonim të kaluarën... Sot edhe fëmijët tanë në këtë vend të bukur me demokraci të vërtetë kanë krijuar familjet e tyre dhe jetojnë komfort standardit të shoqërisë zelandeze". Sipas Petrit Allit, i lindur në Tiranë 1930, i arratisur në vitin 1948, se pari në Turqi e pastaj në Zelandë të Re, personalitet i respektuar dhe emër i njohur i futbollit zelandez në vitet 1952-1956. Rreth viteve '70, '80 të shekullit të kaluar pati ardhje në mënyrë individuale, kurse pas vitit 1990 për shkak të ndjekjeve, burgosjeve e vrasjeve të shqiptarëve në Kosovë, eksodit masiv në Shqipëri, u rrit paksa numri i atyre që vinin në Zelandë të Re. Vala e dytë, kjo e fundit, e imigrimeve masive u bë pas zhvendosjeve të dhunshme, gjenocidit në Kosovë, në pranverën e vitit 1999. Më, 22 maj 1999, erdhën refugjatët e parë shqiptarë, të cilët u morën në mënyrë të organizuar nga Qeveria zelandeze në kampet e refugjatëve në Maqedoni. Në aeroportin e Aucklandit del i gjithë komuniteti shqiptar, i madh e i vogël, shumë zelandezë e të tjerë, në krye me kryeministreshën e atëhershme të Qeverisë së Zelandës Jenny Shipley me bashkëpunëtorë si dhe përfaqësues të opozitës për t'u uruar



Auckland, 1960. Restoranti "Free Albania" pronë e Mazhar Krasniqit



Auckland, 2010. Petrit Alliu dhe Bajram Murati (tashmë i ndjerë) në mbledhjen përkujtimore me rastin e vdekjes së bashkëpatriotit të tyre, Fadil Kacelit



Auckland, 8 mars 1998. Nën at shqiptare në protestë: Stop, masakrave në Kosovë

Genocidi në Kosovë, si emigruan në Zelandën e Re

Pas emigrantëve të parë në vitet 1945-1950, një valë e re emigrantësh mësynë Zelandën e Re pas viteve '90, dhe kryesisht në 1999 gjatë luftës së Kosovës...



Auckland, 8 mars 1998. Nën at shqiptare në protestë: Stop, masakrave në Kosovë

mirëseardhje refugjatëve nga Kosova.

REFUGJATËT E RINJ TË '99-S

Ardhjet vazhduan gjatë tërë vitit 1999.

Duhet përmendur se në mesin e refugjatëve pati edhe personalitete të shquara të kulturës e shkencës shqiptare: Akademik Enver Gjerqeku, shkrimtari Rexhep Hoxha,

Dr. Hysen Ukmata etj. Falë sjelljeve me kulturë, punës me korrektësi, shqiptarët, këtu në Zelandë, respektohen si njerëz punëtorë e familjarë të mirë. Si kudo në botë edhe këtu shqiptarët po tregohen punëtorë e ekonomisë dhe biznesit. Të ardhurit në vitin 1951 ishin kryesisht nga Shqipëria, kurse të ardhurit në vitin 1999 janë nga Kosova. Komuniteti shqiptar është i përqendruar në qytetin Auckland-it. Mundet që edhe në qytete tjera të ketë shqiptarë, por ne nuk i dimë. Në bisedë me mërgimtarët, që kanë ndjekur lëvizjet, ardhjet e shqiptarëve, del se në Zelandë të Re duhet të jenë diku 400 deri 500 shqiptarë. Shqiptarët përbëjnë një pjesë të vogël, por të rëndësishëm të qytetit multikulturor.

Them të rëndësishëm se komuniteti ndër më të pakët në numër ka shumë të diplomuar në universitet e këtushme. Që nga vitet e ardhjes, shkollarët shqiptarë treguan zgjuarsi në shkollat e mesme dhe në fakultete. Në universitetet që radhiten në mesin e universiteteve të njohura në botë, shqiptarët janë ndër më të mirët, më të suksesshmit në mesin vendësve, aziatikëve, evropianëve etj. Suksesi, mendoj unë, është rezultat i sistemit shkollor në Zelandë të Re që ofron kushte e mundësi për t'u shkolluar gjithsecili, është rezultat i interesimit të familjeve dhe vetë studentëve.

"Ardhësit e vitit 1951, thotë Petrit Alliu, shumica prej tyre nuk janë më në jetë. Disa prej tyre që moti janë shpërngulur nga Zelande e Re; në Australi, Amerikë etj. Pasardhësit e tyre po ashtu janë të shpërndarë dhe nuk kem ndonjë evidencë për ta. Ne u martuam me gra jo shqiptare dhe fëmijët tanë nuk mësuam gjuhën shqipe. Shqipëria ishte e ndaluar për neve. Brenda një viti mund ta dërgoja një letër nënës dhe në të nuk guxoja të shkruaj më shumë se "mirë jam". Në Shqipëri shkova pas 50 vjetëve. Tashit shyqyr ka ndryshuar situata për mirë, ju keni mundësi të lëvizni, të jeni në lidhje me familjet tuja në Shqipëri e kudo tjetër, dëgjoni radion shqip, lexoni gazetatat shqip, shkoni e vini, ta ruani dhe mësoni gjuhën fëmijëve tuaj. Ne fatkeqësisht nuk i patëm këto mundësi." -përfundoi xha Petriti. Auckland, mars 2015

De Biasi "driblon" pas pasaportës: S'jam martuar me shqiptare

Tekniku kuqezi status në Facebook: Kjo batutë e imja ka krijuar një keqkuptim

DYLBER BALLA
TIRANE


Pas marrjes së shtetësisë shqiptare dhe fitores me Armeninë, trajneri i kombëtares, tashmë shqiptar Gianni De Biasi përmes faqes zyrtare në Facebook ka gjetur kohën për të bërë një sqarim për sa i përket deklaratës së tij se ishte martuar me një shqiptare. "Kohë më parë, në një intervistë kisha thënë si "batutë" (shaka) që isha martuar me një shqiptare për më tepër se tre vjet dhe nënkuptoja Skuadrën Kombëtare të Futbollit Shqiptar! Kjo batutë e imja ka krijuar një keqkuptim. Sot, dua të konfirmoj që nuk jam i martuar me asnjë grua shqiptare! Jeta ime, familja ime, janë Paola, bashkëshortja ime, dhe Chiara Sofia, vajza ime e adhurueshme" shkruan tekniku italian i natyralizuar si shqiptar, Gianni De Biasi.

MEHA BËHET BABA

Fitorja e Kombëtares përballë Armenisë shoqërohet me një tjetër lajm të mirë për Mehën, i cili është bërë baba për herë të dytë, pasi në jetë ka ardhur djali i tij Lounisi. Të afërmit e familjes Meha tregojnë për Telegrafin se vogëlushi është në gjendje të mirë. Lounisi është fëmija i dytë i Alban Mehës pasi ai ka edhe një vajzë.

AGOLLI, HERO NË AZERBAJXHAN

Llojtari i kombëtares shqiptare, Ansi Agolli është pritur si hero në Karabak, Azerbajxhan pas fitores përballë Armenisë, pasi klubi i tij i kishte premtuar një dhuratë në rast fitoreje. Ashtu sikur pritej, Agolli ka marrë dhuratë një orë Rolex nga presidenti. Madje, trajneri e ka përçafatur Agollin 4 herë, gjë që nuk e ka bërë kurrë më parë me këtë lojtar sipas mediave. "Jam i emocionuar dhe shumë i lumtur. Kemi ngritur pesë zëmrat e gjithë shqiptarëve, por edhe azerëve pas fitores me Armeninë, mbajtja premtimit për fitore" tha ai.




De Biasi me bashkëshorten

CURRI: MAVRAJ, I DUHURI

Pas ndeshjes me kombëtares, mbrojtësi Debatik Curri i është bashkuar Tiranës për të nisur stërvitjen për ndeshjen me Flamurtarin, por nuk të shmangej tema e sfidës së eliminatorëve dhe faktit që De Biasi zgjodhi Mavrajn para tij. Megjithatë mbrojtësi vlerëson zgjedhjen e trajnerit, e cila rezultoi fituese në fund. "Ishte e drejtë të luante Mavraj, pasi ai është aktivizuar në ndeshjet e fundit. Unë kisha probleme fizike në fillim të javës. Mavraj shënoi dhe golin e barazimit dhe prania e tij në fushë shërbeu mirë" tha ai.

Dëmtimi



Hysaj probleme pas ndeshjes ndaj Armenisë: Kavilja cop cop

Mbrojtësi i Kombëtares shqiptare Elseid Hysaj luajti i dëmtuar në ndeshjen ndaj Armenisë. Mbrojtësi i e kishte kaviljen e lënduar, por nuk u dorëzua asnjëherë për 90 minuta. Gjatë ditës së djeshme Hysaj ka publikuar një foto në Facebook, të cilën e shoqëron me statusin "kavilja cop cop". Duket se vendimi për të luajtur deri në fund me Shqipërinë do t'i kushtojë të paktën një ndeshje me Empolin në kampionatin italian.



PRECEDENTI

"Shkjau" përçan kosovarët, TKZ mësim frëngjisht

E ndërsa Kombëtarja fitoi përballë Armenisë duke qetësuar të gjithë zemrat kuqezi dhe rilindur shpresat për një kualifikimin për në kampionatin European të Francës, dy nga grupimet më aktive të tifozëve kuqezinj janë përfshirë në kaos. Pas grindjes në qytetin e Elbasanit pak orë para ndeshjes dhe në stadium, tifozët vazhdojnë ende zënkën e tyre, madje duke e konfirmuar përmes rrjeteve sociale. Tifozët e Prishtinës "Plisat" dhe ata të Trepçës "Torcida" nuk janë pajtuar. Besnik Mujeci përfaqësues i tifozëve, "Plisat" ka thënë se "Torcida" ka provokuar në Shqipëri. Ndërsa Genc Voca tha se "Plisat" i kanë pre në besë dhe këtë nuk do t'ua falin kurrë dhe se nuk do të ketë paqe. "Plisat" kanë reaguar edhe në Facebook përmes një statusi duke sqaruar gjithçka sipas versionit të tyre. "Rivaliteti i Plisave me tifozët nga Mitrovica është i vjetër. Plisat i janë shmangur situatave të tilla në ndeshjet e kombëtares. Të dielën kur Torcida erdhën në Elbasan, ne vecse ishim të vendosur në njerin nga sheshet e këtij qyteti. Sikur në të rastet tjera, kur ata kaluan pranë nesh, ne provuam të qëndrojmë tërësisht indiferent kundrejt tyre. Disa nga ata filluan me thirrjet: "JU JENI SHKIJE"!!! Ne, duke provuar që të mos bijmë në provokimet e tyre të ulëta, ua kthym: "NA JEMI PLISAT"!!! E PLISI dihet që është simbol kombëtar. Sikur kjo nuk iu mjaftoi dhe ata pas sharjeve tjera, filluan me hedhje të sendeve të forta në drejtimin tonë. Nën breshëri të gurëve (ashtu siç ata janë mësuar të bëjnë gjithmonë) dhe të përballur me sharjet e tilla të ulëta, ne me nuk mund të rrinim pa reaguar. Reaguam aq sa ishte e nevojshme t'i qetësojmë ata idiotë, të sëmurë e të kompleksuar, të cilën kush e di se për qëllim të kujt, kanë ardhë në Elbasan që të prishin festën e bukur mbareshqiptare" shprehen ata. Ndërsa grupimi

INCIDENTI



Ballafaqimi

Tifozët nga Trepça, "Torcida" nuk kanë pranuar të pajtohesh me "Plisat" pas grindjes në Elbasan para ndeshjes përballë Armenisë ditën e diel.

REAGIMI



Sqarimi

"Plisat" përmes Facebook sqarojnë se "Disa nga ata filluan me thirrjet: "JU JENI SHKIJE"!!! Ne, ua kthym: "NA JEMI PLISAT"!!! E PLISI dihet që është simbol kombëtar".

SUPERIORJA/ PARTIZANI

Rrahmani: Apolonia, një prej 8 finaleve te sezonit

Lojtari i ekipit të Partizanit, Amir Rrahmani par ndeshjes me Apoloninë shprehet se vlerësimi për kundërshtarin është maksimal, pavarësisht pozicionit që mban në renditje. "Ndaj Apolonisë na pret një ndeshje e vështirë pasi përball do kemi një ekip i cili luan pa presion dhe konstant në çdo ndeshje. Në këtë fazë që jemi çdo ndeshje e luajtur konsiderohet finale pasi nuk ka mundësi të rikuperosh pikët. Apolonia më ka sjell fat pasi ndaj fierakëve kam shënuar edhe golin



tim të parë në këtë sezon që u pasua edhe me dy të tjerë. Sigurisht dëshira ime është të shënoj sërish edhe pse më të rëndësishme janë tre pikët, pavarësisht kush shënon. Personalisht mendoj se kemi shumë shanse për të dal kampionë thjesht duhet të vlerësojmë 8 takimet që konsiderohen të gjitha finale" Aktualisht Partizani është në garë për titullin kampion dhe së bashku me Skënderbeun, Kukësin dhe Tiranën do të garojnë deri në fund për trofeun.

më i madh i tifozëve të kombëtares, "Tifozat kuq e zi" përmes një statusi në Facebook e cilësojnë si të kryer çështjen e kualifikimit në kampionatin European, pasi kanë publikuar një status kur shprehen se kanë nisur të mësojnë frëngjisht. "Nga sot fillojmë me mësimet e gjuhës frënge. Do të na duhet së shpejti. Mësimi 1: Je suis albanaise (Unë jam Shqiptar)".

PARADE FJALEKRYQESH NGA KADRI VOKOPOLA



VIDEO/ SARAH NILE KALENDARI I EGER I 2015



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas

HOROSKOPI

- Horoscope entries for various zodiac signs: Dashi, Demi, Binjakët, Gaforrija, Luani, Virgjëesia, Peshorja, Akrepi, Shigjetari, Brircjapi, Ujori, Peshqit.

FJALËKRYQI PA SKEMË DUHET TË NXINI 33 KUTI

Empty crossword grid with columns numbered 1 to 17.

HORIZONTAL

- Horizontal clues: 1. Janë finko, 2. Janë princër arabë, 3. Gjysmë cinke, 4. Oz shkrintar izraelit, 5. Institucione Autonime Tiranë, 6. Numër i shkurtër, 7. Thatcher, që thirrje Iron Lady, 8. Janë programe gjimesh, 9. Oliver Reed, 10. Ai i sportit nuk ka apartament, 11. Një pjesë e aeroplanit, 12. Janë programe gjimesh, 13. Një vel mjegulla, 14. Janë shprehje algjebrike, 15. Janë programe gjimesh, 16. Ekstremitet në tunel, 17. Një vel mjegulla.

VERTIKAL

- Vertical clues: 1. Janë finko, 2. Në fundit një studim, 3. Solla duhanin në Europë, 4. Kufizim një hap, 5. Loja trener, 6. Ruhet në fund, 7. Bubka që kërcente me shkop, 8. Ishin mongolë të Timurlengut, 9. Drejtohen për zoom, 10. Jep alarmin një e tillë, 11. Një frymor si oboe, 12. Eshhtë për të grë qepë një e tillë, 13. Një zinxhir kinemashë në Britaninë e Madhe, 14. Institucione Ndërmjetëse Rajonale, 15. Në fund majtas, 16. As unë as ti, as ai, 17. Mbyllin koncertin, 18. Dinë të fiasin.

Partial crossword grid showing the intersection of horizontal and vertical words.

Përgjigje e fjalëkryqit pa skemë

Sudoku

Sudoku grid with some numbers pre-filled.

Përgjigje

Solved Sudoku grid.

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo rresht e kolonë të ketë numrat nga 1-9

FJALEKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

Përgjigje

Cryptogram grid with letters A-Z.

SHKRONJA E NJËTË PËR NUMËR TË NJËTË

Large cryptogram grid with numbers and letters.

Përgjigje e fjalëkryqit sportiv

Sports-themed cryptogram grid.

- Sports-related clues: 6. Qendër ditore, 7. Zubizarreta që që portier, 8. Fillojnë matanë, 9. Skuadër e Pragës, 10. Lishë bomber egjiptian, 11. Gjysmë retine, 12. Eshhtë fituese e medaljes së artë, 13. Vasil, ish bomber i Flamuritari, 14. Parashitesë zmadhuese, 15. Veshje indiane, 16. Saliut-Germanin në futboll, 17. Tekejt e një radhe, 18. Një rrugëtim i rendit, 19. Gjysmë assist, 20. Me të bëjnë një motor, 21. Fillojnë vrapimin, 22. Ajo e zezë e futbollit është Pelé, 23. Në një të tillë është ekipi që nuk ka rezultate, 24. Malet pa kufij, 25. Staff pa ekstreme, 26. Pak servilizëm, 27. Një pjesë e evidencës, 28. Gjysmë rebusi, 29. Iniciallet e Redford, 30. Fillon nga fundi, 31. Sean Connery, 32. Ekstremitet në truk.

FJALËKRYQI SPORTIV

Sports-themed crossword grid with images of athletes.

HORIZONTAL

- Sports clues: 1. Iniciallet e Ferguson, 2. Eshhtë tapeti në judo, 3. Një pjesë e ekspertëve, 4. Eshhtë gara me të gjatë, 5. Janë skuadrat që luajnë në shtëpi të vet, 6. Kështu fillon sporti, 7. Eshhtë Arabia në Riad, 8. Ka vijën fatale, 9. Një pjesë e praktikës, 10. Reus të Borussia Dortmund, 11. Eshhtë... Sar ish-portier holandez, 12. Mund të ushtrohet edhe

me cricket,

- Sports clues: 13. Skuadër greke, 14. Ekstremitet në fizik, 15. I fundit është mbi të gjithë, 16. Ela e volejbollit, 17. Matet pa kufij, 18. Personazhi në foto, 19. Personazhi në foto, 20. Personazhi në foto, 21. Personazhi në foto, 22. Personazhi në foto, 23. Personazhi në foto, 24. Personazhi në foto, 25. Personazhi në foto, 26. Personazhi në foto, 27. Personazhi në foto, 28. Personazhi në foto, 29. Personazhi në foto, 30. Personazhi në foto, 31. Personazhi në foto, 32. Personazhi në foto, 33. Personazhi në foto, 34. Personazhi në foto, 35. Personazhi në foto.

LAJME
nga bofa

Edhe Kosova humb dixhitalizimin

— Edhe Kosova e ka humbur afatin e përcaktuar nga rregullorja europiane për 17 qershorin për të kaluar nga sistemi analog i transmetimit TV në atë numerik, duke rrezikuar kështu të punojë me frekuenca që nuk kanë mbrojtje ndërkombëtare. Komisioni i Medias dorëzoi këtë të martë në qeveri strategjinë e përgatitur për kalimin në transmetim dixhital tokësor. Për të vazhduar puna, Qeveria duhet të nxjerrë ligjin, i cili do të përcaktojë metodën dhe kushtet për transmetimin dixhital. Deri tani, procesin e dixhitalizimit në rajon e kanë përfunduar Maqedonia, Kroacia dhe Sllovenia. Në Kosovë puna ka nisur më 2007, por nuk ka një ligj.

Irak, ushtria çliron Tikritin

— Kryeministri irakian Haider Al Abadi ka deklaruar zyrtarisht dje çlirimin e qytetit të Tikritit nga forcat xhihadiste. Al Abadi, i cili është dhe komandanti supreme ushtarak i vendit, u shpreh në televizionin shtetëror: "Kemi çliruar qytetin Tikrit nga ISIS-i". Ky qytet ka qenë nën sundimin e militantëve islamikë që prej muajit qershor të vitit të kaluar. Forcat e ushtrisë irakiane kanë rifituar tashmë kontrollin mbi të gjithë objektet qeveritare në qytet. Çlirimi i qytetit i mundësua nga bashkëpunimi me forcat ajrore amerikane, të cilat intensifikuan sulmet ajrore intensive ditë e fundit.

Merret peng prokurori në Turqi

— Sulmohet me armë një gjykatë në Stamboll, ku një prokuror është marrë peng. Ai kishte drejtuar hetimet për vrasjen e një 14-vjeçari që u qëllua për vdekje gjatë përleshjeve në parkun Gezi në vitin 2013. Pengmarrësit i përkasin një grupi të së majtës ekstreme i quajtur Fronti i Partisë për Çlirimin e Popullit Revolucionar. Ata kanë paraqitur disa kërkesa, mes tyre edhe thirrjen që oficerët e policisë që vranë 14-vjeçarin të pranojnë krimin drejtpërdrejt në TV. Adolshenti Berkün Elvan u qëllua në kokë gjatë përleshjeve të armatosura ndërsa kishte dalë për të blerë bukë. Ai vdiq pas 9 muajve, duke u shndërruar në një simbol të shtypjes së fortë kundër të rinjve në parkun Gezi.



Emisioni Tëte à Tëte moderohet nga gazetari i mirënjohur

ARTUR NURA

dhe ndiqni çdo të **hënë**, të **mërkurë** dhe të **premtë** në orën **18:10- 19:55** në **TV**

A1 REPORT!

Ritrasmentim: Të martën 00:30
Të mërkurë, të premtë 23:30



Të ftuarit e Tëte à Tëte vijnë nga fusha e politikës, shoqërisë civile, feve, shkencës dhe arteve të bukura ku ata/ato që sjellin në vëmendjen publike qasjet e tyre specifike kryesisht për temat më të ndjeshme për publikun

Në fokus të këtij emisioni vijnë herë pas herë edhe individë të cilët kanë/janë zë i veçantë në fushat e tyre si mjekë, stilistë, inxhinierë apo edhe biznesmenë të suksesshëm

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi"; Politika: Juxhin Mustafaraj ; Ekonomi: Lorenc Rabeta; Aktualitet: Elton Qyno ;
Socialia: Sonila Isaku ; Kulturë: Dhurata Hamzai; Sporti: Dylber Balla ; Design: Altin Allaj, Erjon Ymeri; Website: Greta Malaj; Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355696088847

Departamenti i Marketingut:
Vera Përleka
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë